

LEXMARK
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488
ALDO: 07494181220
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,
27-37 Station Road, Hayes, UB3
4DX



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 TETOR 2023

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

ANGLIA PRET DYNDJE EMIGRANTËSH ALARMI I BRAVERMAN PËR NJË 'STUHI'



PETRIT KUÇANA
**KUR DO TË
IKIM NGA
AFRIKA?**

**LETRA E FUNDIT
E EDITH
DURHAMIT**
DAUT DAUTI



ARBEN MANAJ

Ministrja e Brendshme britanike,
Suela Braverman ka paralajmëruar për një 'stuhi' emigrantësh
drejt Britanisë, gjatë një fjalimi në
Konferencën e Partisë Konservatore,
fjalim që është cilësuar nga
kundërshtarët si fjalim populist.

(vijon faqe 4)

**TË BASHKUAR PËR KOSOVËN,
TË MIRATOHET NJËZËRI
REZOLUTA NË KUVENDIN E
SHQIPËRISË**

DITMIR BUSHATI

**LIRIA
E PESTË**

VETON SURROI

**KOSOVËN MË SHUMË
E KA DËMTUAR RAMA
SA VUÇIQI**

KIM MEHMETI

**RAMA, PAPAGALLI
I VUÇIÇIT,
ME GJUHË PATRIOTIKE**

ANDI BUSHATI



Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Seksioni i FDI Intellegence në Financial Times llogariti se Shqipëria bashkë me 9 vende afrikane kishin nivelin më të lartë të emigrimit të trurit edhe në vitin 2022.

Për vite me radhë, Shqipëria po renditet në listën e vendeve me nivelin më të lartë të emigracionit të popullsisë të arsimuar, i njohur si fenomeni i "Brain Drain" (emigrimi i trurit) në raport me popullsinë.

Ky duhej të ishte një nga ato lajmet e kobshme për çdo shoqëri dhe për çdo institucion shtetëror.


Mjerisht në Shqipëri ky lajm kalon thujtë papërfillshëm, ku mediat kryesore nuk e shohin të arsyeshme qoftë edhe ta transmetojnë si të tillë.

Shpopullimi i Shqipërisë jo rrallëherë është justifikuar nga pushtetarët si një dukuri thujtë normale, por nuk kemi dëgjuar për ndonjë justifikim "Brain Drain" (Emigrimi i trurit).

Nuk besohet të ketë PR (patronazhist ekрани), që të justifikojë renditjen e Shqipërisë me vendet e Afrikës për largimin e trurit, përkrah Eritreas, El Salvadorit, Xhamajkës apo Haitit.

(Në zejen e gazetarisë gjithkush do të pyeste se a po e mbron media interesin publik dhe lehtësisht mund të rikonfirmonte domosdoshmërinë e pasjes së ndonjë Agon Channel...)

KUR DO TË IKIM NGA AFRIKA?



Mbase shumë kujt i kujtohet demarshi në prag fushatën elektorale, Edi Rama si lider i opozitës, ndër morri një fushatë për të përfshirë profesorë apo intelektualë të ndryshëm nga diaspora në mbështetje të tij.

Që nga ajo kohë nuk kemi pare një tentativë të vetme serioze për "Brain Gain"

Kaq kokëforta janë shifrat e shqiptarëve azilkërkuës, saqë duket se parashikimet e institucioneve ndërkombëtare për një Shqipëri me më pak se 1 milion banorë po realizohet.

Mjerisht Shqipëria është kthyer në një komb që prodhon emigrantë dhe se çdo

(thithjen e trurit) që do të konsistonte në projekte afatgjata dhe strategji të mirëmenduara, së pari për krijimin e hapësirave dhe mundësive për "mbajtjen e trurit" dhe së dyti për sjelljen apo kthimin e profesionistëve nga diaspora.

Jo vetëm që nuk e vë kush ujë në zjarr qoftë edhe për të diskutuar këtë temë tejet shqetësuese për çdo shoqëri, por pandjeshmërisht kalohet edhe pa tre ditëshin e famshëm të së keqes më të madhe.

sondazh tregon zyrtësinë e së ardhmes. Vetëm në Britaninë e Madhe rreth 12 000 shqiptarë kanë kërkuar azil vitin e kaluar.

Kjo është një shifër tepër dramatike për një vend të vogël si Shqipëria.

Është vërtetë shumë edhe sikur të jenë 12 000 studentë, apo 12 000 të diplomuar që po trajtohen në Britaninë e Madhe apo që po kryejnë studime pasuniversitare.

Këta emigrantë janë lënë në mjerimin e tyre, me shanse thujtë zero për të fituar azilin, ku mjerisht një pjesë e madhe bien viktima të krimit, duke mos lënë në asnjë moment të pushojnë kronikat e zezë për shqiptarët.

Kërkohet më shumë se përgjegjshmëri, për të sensibilizuar këdo që i dhemb ky fenomen për të cilin kërkohet ndërhyrje urgjente para se të jetë tepër vonë.

Të paktën të ikim pak nga Afrika, të paktën...

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London. TW3 1PA



**Imperium
Chambers**

Tel: 0207 242 3488

**Address: 2 Selkirk Road,
London SW17 0ES**

Email: enquiries@imperiumchambers.co.uk

Website: www.imperiumchambers.co.uk

YouTube: The Immigration Barrister

**A JENI MARTUAR PAS DATËS
31 DHJETOR 2020 DHE JU
ËSHTË REFUZUAR APLIKIMI
I EU SETTLEMENT SCHEME
(EUSS)?**

**DONI TË APELONI ÇESHTJEN
TUAJ NË SHKALLËN E PARË
APO TË DYTË TË APELIT?**



**ME NJË GARANCI SUKSESI TË LARTË NË TË GJITHË APELET BARISTERËT TANË TË KUALIFIKUAR
DHE ME EKSPERIENCË E NDJEKIN ÇESHTJEN TUAJ NGA FILLIMI NË FUND**

SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE

Human Rights

Judicial Review

Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims

Asylum

Overstayers

Stateless

Detention & Bail

EEA family permit

EEA Permanent Residence

Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality

Spouse Visa

Visitor Visa

Dependent children

Student,

Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin
e shtetesise nga **Kosovar** ne **Shqiptar**

Per me shume informacion kontaktoni Adelen

Fully accredited by the
Bar Standard Board



**BAR
STANDARDS
BOARD**

Imperium Chambers

4.8 ★★★★★ (141) ⓘ

Lawyer in London, England · [Open](#)

Mob:

07901181592



ARBEN MANAJ

Ministrja e Brendshme britanike, Suela Braverman ka paralajmëruar për një 'stuhi' emigrantësh drejt Britanisë, gjatë një fjalimi në Konferencën e Partisë Konservatore, fjalim që është cilësuar nga kundërshtarët si fjalim populist.

Ndërkohë vetëm gjatë tre ditëve të fundit kanë kaluar La Manshin rreth 1 mijë veta, mes tyre edhe shqiptarë, ndërkohë që në një raport të cituar nga media thuhet së tre çereku i atyre që vijnë me gomone do mund të marrin azilin ose do qëndrojnë në ishull, pasi nuk mund të dërgohen në vendet nga kanë ardhur.

Për ta bërë më të fortë deklarinimin e saj për stuhinë e pritshme të emi-

ANGLIA PRET DYNDJE EMIGRANTËSH ALARM I BRAVERMAN PËR NJË 'STUHI'

grantëve drejt ishullit, Ministrja e Brendshme britanike, Suela Braverman, vetë fëmijë emigrantësh indian të Afrikës, tha se "era e ndryshimit që solli prindërit e mi nga ana tjetër e globit shekullin e kaluar ishte thjeshtë një puhizë e krahasuar me stuhinë e pritshme".

Kjo deklaratë e bërë në Konferencën e Partisë Konservatore të qendrës së djathtë në pushtet prej 13 vjetësh, ndodh në ditët kur vetëm gjatë ditëve të kësaj Konference, 1000 emigrantë kanë shkuar në Britani me gomone nga Franca, së cilës Londra i ka paguar afro gjysmë miliardë sterlina që ta frenojë këtë fluks, dukshëm duke dështuar, fluks që më shumë shpjegohet me kohën e mirë në ngushticë sa herë rriten shifrat.

Mes të ardhurve ka edhe shqiptarë, edhe pse në numra shumë më të vegjël se vitin e kaluar.

Më shumë se mbi 25 mijë emigrantë kanë ardhur deri më tani me gomone, krahasuar me 33 mijë në fillim të



tetorit të vitit të kaluar.

Duke cituar një raport të Refugee

Council, gazeta Evening Standard, shkruan së treçereku i atyre që kanë kaluar La Manshin me gomone këtë

vit, do njihen si refugjatë, nëse u shqyrtohen aplikimet për azil dhe vetëm 3.5 për qind e të ardhurve, do mund të kthehen në vendet e tyre.

Aplikimet u aprovohen 100 për qind të ardhurve nga Eritrea, 99 për qind të sirianeve dhe 97 për qind afganëve. Analiza tregon se rënia me 20 për qind këtë vit shpjegohet me rënien e numrit të shqiptarëve, pas marrëveshjes mes Ramës dhe Sunak.

Kur shifra totale e të ardhurve me gomone ishte 19.500 gjatë këtij viti, 660 që deklaruan kombësinë ishin shqiptarë.

Edhe pse Shqipëria konsiderohet si vend i sigurt, sërish nëpër gjykatat britanike të emigracionit, shqiptarët vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të fitojnë rastet e kërkesave për azil, në bazë të meritës së aplikimit, sidomos për moshat nën 25 vjeç. tch

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E
EMIGRACIONIT

A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuar
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

SHËRBIME TË REJA:

- 1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:**
Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.
- 2. Ndihmë e dhembshur për të drejtën e familjes:**
Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.
- 3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:**
Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

ALARM I KUQ PËR AVIACIONIN FRIKË NGA SHITJA E PJESËVE ME DEFECT NGA NJË FIRMË ME CERTIFIKATË FALSE

ARBEN MANAJ

Industria britanike e aviacionit ndodhet në alarm të kuq pasi një kompani, e cila furnizon pjesë për motorët e avionëve i ka shitur ato me certifikatë false sigurie, çfarë ka çuar në fillimin urgjent të hetimeve.


Pjesët e motorëve janë për avionët e modelit të vjetër të serisë Airbus A320 dhe avionët Boeing 737. Nga ky skandal është përfshirë edhe industria e linjave ajrore në Shtetet e Bashkuara, pasi linjat ajrore Amer-

ican Airlines, United Airlines and Southest Airlines, njoftuan heqjen nga fluturimet të avionëve të këtyre modeleve.

Pajisjet nga kompania britanike AOG janë vendosur edhe në avionët e linjave ajrore britanike. Certifikatat e sigurisë që pretendohet se janë të falsifikuar janë për pjesje që janë instaluar në të paktën 126 motorë të avionëve të prodhimit evropian Airbus dhe atyre amerikan Boeing. Besohet se pjesët përfshijnë vidat e vogla dhe bulonat deri te helikat e rëndësishme të turbinave.

Ndër gjashtë kompanitë ajrore britanike, ku tre prej të cilave kanë fluturime direkte nga Britania drejt Shqipërisë dhe Kosovës, këto pjesje nuk janë instaluar në avionët e British Airways, Wizzair dhe avionëve të kompanisë Ryanair, e cila fillon fluturimet në fund të tetorit nga Londra, Birminghami, Mançesteri dhe Edinburgu drejt Tiranës.

Avionët e këtyre tre linjave janë të sigurta, së bashku me avionët e linjave, Jet2 dhe Virgin Atlantic.



Autoritetet irlandeze janë duke u përgatitur dhe paralajmërojnë për një valë vrasjesh dhe një kasaphanë mes kartelevë të drogës pas kapjes së sasisë më të madhe në historinë e atij vendi të kokainës me një vlerë 430 milionë sterlina.

Karteli vrasar kolumbian, Gulf Clan, një konsorcium kriminal evropian i drejtuar nga shqiptarët dhe karteli irlandez Kinahan mendohet, sipas hetuesve se janë grupet kryesore kriminale, pas kësaj dërgese të kapur nga forcat speciale në një anije transporti. Mendohet se janë 20 grupe me qendër në Evropë të përfshira në operacionin e trafikimit të drogës të ideuar dhe drejtuar nga Dubai, ku besohet se jetojnë shumica e figurave më të rëndësishme të trafikut të kokainës, mes tyre edhe shumë bosë të krimit shqiptar.

Hetimet po kryhen në bashkëpunim me Emiratet e Bashkuara Arabe, për identifikimin e atyre që qëndrojnë pas organizimit të kësaj dërgese kokaine, dhe sipas gazetës Irish Examiner, karteli kolumbian më i madh Clan del Golfo si dhe një konsorcium kriminal evropian i drejtuar nga shqiptarët, janë të dyshuarit kryesor të kësaj dërgese që ka nisur nga Venezuela.



Besohet se karteli irlandez Kinahan ka gisht në këtë operacioni trafikimi

PRITET KASAPHANË PAS KAPJES SË KOKAINËS 430 MILIONË STERLINA TË DËRGUAR NGA KOLUMBIANËT DHE SHQIPTARËT NË IRLANDË

të drogës nga Amerika e Jugut. Ka një shqetësim të madh në radhët e autoriteteve ligj zbatuese se pritet një kasaphanë e vërtetë dhe vrasje mes kartelevë dhe grupeve kriminale pas humbjes së një sasie kaq të madhe kokaine.

Ishte informacioni i dhënë nga DEA amerikane që çojë në kapjen e kësaj ngarkesë droge, pas ndërhyrjes dhe një operacioni mjaft të

madhe të forcave special në det në bordin e anijes Mathew e nisur nga Venezuela në 18 gusht, e cila pasi kaloj Atlantikun, qëndroj një javë në ishujt Kanarie përballë Afrikës dhe më pas vazhdoj udhëtimin pa qëndruar në Spanjë dhe Francë për tu ndaluar në afërsi të Irlandës.

Sipas specialistëve, sasisë e mëdha të drogës të dërguara nga Amerika Latinte tregojnë qartë për sasinë e mëdha të drogës në dispozicion si dhe sasinë e parave të gatshme për blerjen e saj në Evropë. A.M TCH

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



VAL CLINIC

NESE JU DUHET NJE DOKTOR
MOS HEZITONI TE VIZITONI
VAL CLINIC

THE BEST MEDICAL CENTER

OUR SERVICES:

CARDIOLOGY
ENT
PAEDIATRICS
GYNAECOLOGY
DERMATOLOGY
INTERNAL MEDICINE
RADIOLOGY
PHYSIOTHERAPY
NEUROLOGY
SURGERY AND MINOR INJURY
UROLOGY
ENDOCRINOLOGY
GASTROENTEROLOGY
AESTHETIC MEDICINE
PODIATRY
FULL CHECK-UP
PSYCHOLOGY
PSYCHIATRY
DIAGNOSTICS:
ALL TYPE OF BLOOD TEST
AND SWABS AFTER
DOCTORS
CONSULTATION



**PERSHENDETJE,
JAM DR. ARJOLA DHE PUNOJ
NË VAL CLINIC QË ËSHTË NJË
KLINIKË NË LONDËR ME
MJEK/E SPECIALISTË TË
GJITHË SHERBIMEVE
MJEKESORE. PËR ÇDO
PROBLEM NA KONTAKTONI**

NA KONTAKTONI



INFO@VALCLINIC.CO.UK
WWW.VALCLINIC.CO.UK

39 Frederick Road
Rainham RM13 8NJ
Tel: 01708701155
Mob: 07307595437



DAUT DAUTI

Në fund të muajit maj të vitit 1944, Edith Durham ia shkroi një letër mikut të saj, Morantit, ku i thoshte se e kishte festuar ditëlindjen me një stil të lartë. Do të ishte kjo ditëlindja e fundit e anglezes që u doli në mbrojtje shqiptarëve. Pas pak kohësh Durhamit filloi t’i keqësohej shëndeti dhe ndoshta kjo është letra e saj e fundit që ka shkruar.

Durham mburrej me punën e saj, të cilën e theksonte kur kishte nevojë. Njësoj e theksonte edhe aktivitetin e saj në fushën humanitare, aktivitetin politik dhe studimet që kishte bërë në antropologji. Në letër, ajo i shkroi Morantit:



“Më duhet të them se shqiptarët nuk i kanë harruar shërbimet e mia të ndihmës humanitare. Kolonia e shqiptarëve në ShBA m’i ka dërguar 132 funte për ditëlindjen time, duke ma

bërë me dije se unë i kam ushqyer ata, dhe tash ata duhet patjetër të më ushqejnë mua. Po ashtu, më kanë dërguar një duzinë të pakove me ushqime. Jam prekur thellësisht.”

Me 30 tetor 1944, disa miq të Durhamit, përfshirë Noel Baxtonin dhe Edward Boylein, e morën një iniciativë që ta themelonin një fond si shenjë mirëkuptimi apo falënderimi të

punës së dalluar të Durhamit në fushën shkencore dhe në punën e saj në Ballkan. Ata planifikuan që këtë fond t’ia jepnin për ditëlindje dhe ajo ta përdorte sipas dëshirës. Por, Durham vdiq dy javë pas kësaj iniciative.

Disa javë pas vdekjes së Durhamit, L. G. Whickham-Legg, redaktori i “The Dictionary of National Biography”, i shkroi akademikut të famshëm Robert Seton-Watson, me të cilin Durham nuk kishte marrëdhënie të mira për shkak të Shqipërisë. Redaktori nuk dinte shumë për Durhamin dhe kërkoi këshilla nga Seton-Watsoni.

Ai, po ashtu pyeti Seton-Watsonin nëse mund të shkruante një artikull prej 400 fjalëve për jetën e Durhamit, në mënyrë që të botohej në këtë revistë të rëndësishme ku shënoheshin njerëzit e arritur. Seton-Watson, i cili e mbronte Serbinë, nuk u përgjigj kurrë.

Në “The Oxford Dictionary of National Biography”, Edith Durham hyri në vitin 1993.

Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI
SHQIPERI - ANGLI

SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds -Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952
AL: 00355682948843
AL:00355694031009

TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

+44 7741 588799

+355 67 728 2828

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

ANGLI

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

Ju Faleminderit qe na besoni!

byzantine

PRODUCTS

Byzantine Products Ltd
Meadow Lea Nursery
Dobbs Weir Road
CM19 5JX



Contact : 07366688832 Email: sales.byzantine@gmail.com

SHQIPËRIA NË MESIN E 10 VENDEVE TË PARA NË BOTË PËR EMIGRACIONIN E TRURIT TË TJERAT JANË NGA AFRIKA


Për vite me radhë, Shqipëria po renditet në listën e vendeve me nivelin më lartë të emigracionit të popullsisë të arsimuar, i njohur si fenomeni "Brain Drain" (emigrimi i trurit) në raport me popullsinë.

Seksioni i FDI Intelligence në Financial Times llogariti se Shqipëria bashkë me 9 vende afrikane kishin nivelin më të lartë të emigrimit të trurit edhe në vitin 2022 (shiko grafikun e mëposhtëm).

"FDI Intelligence" analizoi të dhënat nga 179 vende në të gjithë botën dhe për vitin 2022, rezultoi se ishulli polinezian i Samoas ishte kombi më i prekur, me nivelin më të lartë të emigrimit të "kapitalit njerëzor dhe ikjes së trurit".

Ai u pasua nga Xhamajka, Palestina, Mikronezia, Somalia, Eriteria, El Salvador, Shqipëria, Haiti dhe Guyana. Siç shihet nga të dhënat, Shqipëria është i vetmi vend jashtë Afrikës për nivelin më të lartë të emigrimit të trurit duke u renditur e 8-ta në rang global në vitin 2022.

Situata e largimit të trurit nga Shqipëria ka qenë më e rëndë para pandemisë Covi-19. Studimi tregon se Shqipëria ishte e katërta në rang global për nivelin e lartë të emigrimit të trurit.



Largimi i trurit, i cili i referohet një numri të madh njerëzish të arsimuar ose profesionistë që lëvizin për të jetuar dhe punuar jashtë vendit, mund të rëndojë shumë në perspektivat e zhvillimit të një vendi. Hartuesit e raportit vunë në re se emigrimi i trurit ishte tipar i shteteve ishullore përveç Shqipërisë.

Autorët e studimit evidentuan se emigrimi i trurit vjen si kombinim i faktorëve politik, klimatike dhe ekonomike. Përveç shteteve të vogla ishullore në zhvillim, vendet në Afrikën Sub-Sahariane janë gjithashtu të prekura nga largimi i kapitalit njerëzor.

Pothuajse gjysma e 89 vendeve kishin ikje të trurit mbi mesataren dhe shumica e tyre janë në Afrikën Sub-Sahariane, sipas analizës së FDI. Ndërsa arsyet e emigrimit ndryshojnë ndërmjet individëve dhe vendeve, ikja e trurit ndikohet gjerësisht nga presionet politike, ekonomike dhe mjedisore.

Mungesa e fuqisë punëtore që nga pandemia Covid-19, si dhe plakja afatgjatë, ka bërë që disa vende të konkurrojnë për të tërhequr njerëz të aftë, gjë që ka përshpejtuar ikjen e trurit nga vendet e tjera.

Vendet me të ardhura të larta, të cilat zakonisht ofrojnë mundësi më të mira ekonomike dhe më shumë stabilitet politik, priren të kenë nivele shumë më të ulëta të largimit të kapitalit njerëzor.

Në vitin 2022, Australia kishte rezultatin më të ulët të indeksit prej 0.4, e ndjekur nga Suedia (0.6), Norvegjia (0.6), Kanadaja (0.7) dhe Zvicra (0.8). Katari, një shtet i pasur i naftës, ishte i vetmi emër i Lindjes së Mesme që u shfaq në 10 vendet me rezultatet më të ulëta të treguesve të ikjes së trurit.

Të gjitha studimet tregojnë që Shqipëria u përfshi në një valë të re emigracioni dekadën e fundit, e cila preku të gjithë popullsinë dhe nivelet e arsimit. Emigracioni ka shkaktuar emergjencë për punonjës të gjithëMbizneset. /B.Hoxha Monitor

DITI TRANSPORT

»» ANGLI-SHQIPËRI-ANGLI »»

Shërbim korrekt
Çmime konkurruese



FALEMINDERIT MIJËRA KLIENTËVE QË NA BESOJNË PREJ VITSH



NA KONTAKTONI



0035569 216 5221

0035569 861 5790



0044779 611 1539

0044744 484 5606

»» GRUMBULLIMI NË ANGLI

✓ SHEFIELD

✓ LUTON

✓ LEICESTER

✓ WIMBELDON

✓ HOUNSLOW

»» GRUMBULLIMI NË SHQIPËRI

✓ TIRANË

✓ ELBASAN

✓ BELSH

✓ BERAT

✓ DURRES

✓ HAS

✓ KUKES

✓ RRESHEN

✓ LEZHE

✓ SHKODER

DEPUTETJA BRITANIKE: TË KRIJOHET NJË ALEANCË E RE SHBA-BRITANI-KOSOVË

ALICIA KEARNS

Mosndëshkimi ngjall përbuzje për sundimin e ligjit dhe rendit. Ne po e shohim këtë në Ballkan, ku sulmet e organizuara ndaj zbatimit të ligjit dhe dhuna gjithnjë e më e shpeshtë nga secesionistët serbë në Kosovë dhe Bosnje kërkon vëmendje urgjente ndërkombëtare.

Pasojat e dështimit për një rajon që tashmë ka vuajtur qaq shumë kohët e fundit nuk mund të mendohen. Ne kemi nevojë urgjente që komuniteti ndërkombëtar të rivlerësojë qasjen e tij, t'i japë përparësi llogaridhënies dhe të forcojë masat e sigurisë për të rihapur rrugën për një të ardhme paqësore dhe të begatë, pa konfliktet e së shkuarës.

Ngjarjet e fundit në Kosovë kanë shpalosur një përshkallëzim thellësisht shqetësues të dhunës. Një polic u vra tragjikisht këtë fundjavë gjatë një sulmi të pacipë në veri të vendit. Duke parë afërsisht tridhjetë luftëtarët përgjegjës, ne shohim individë më të ngjashëm me ushtarët, të armatosur me transportues personeli dhe sisteme të gradave ushtarake. Për rrezikun e grupeve të tilla që veprojnë në veri të Kosovës kam paralajmëruar edhe më parë në një fjalim parlamentar në muajin korrik.

Duke pasur parasysh llojin e pajisjeve që militantët kishin, ka pyetje serioze nëse ata mbështeteshin dhe organizoheshin drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë. Udhëheqësi i grupit të armatosur – i cili ka marrë përgjegjësinë – ishte Milan Radojiçiq, nënkryetar i partisë Lista Serbe dhe një i besuar i presidentit Vuçiq. Nëse sulmi është kryer me mbështetjen e serbëve nga Serbia – për të cilën ai pretendon se nuk ka qenë – duhet të ketë veprime të vendosura nga MB, SHBA, dhe BE. Nuk ka vend për 'balanc të rremë' nëse siç duket nënkryetari i një partie politike ka marrë armët dhe ka kryer vrasjen e një polici në shërbim.

Përgjegjësia për këto veprime është parësore, veçanërisht për Beogradin, i cili vazhdimisht ka shmangur pasojat. Në mënyrë shqetësuese, Radojiçiq pohon se është i lumtur që do të dërgohet në Serbi për t'u përballur me prokurorinë, por jo në Kosovë ku është kryer krimi dhe ku një familje mban zi. Radojiçiq duhet të përballet me drejtësinë në Kosovë ku një familjeje i është vjedhur më i dashuri, mund të përballet me të në gjykatë. Por përgjegjësia shtrihet përtej këtij akti të menjëhershëm.

Pavarësisht angazhimit të Kosovës për bashkëpunim me Britaninë e Madhe, SHBA-në dhe BE-në, ajo është përballur me një sërë akuzash të padrejta, duke filluar pasi qeveria serbe mbështeti një bojkot të zgjedhjeve komunale nga serbët e Kosovës në veri. Ne dhe aleatët tanë shprehëm



mbështetjen tonë për zgjedhjet që do të mbaheshin para se të tërhiqemi dhe të ndëshkojmë Kosovën për vendosjen e kryetarëve të komunave, për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së serbëve etnikë. Kishte pak ose aspak kritika ndaj qeverisë së Serbisë, pavarësisht lidhjeve të tyre të dokumentuara mirë me partinë Lista Serbe dhe mbështetjen e tyre për bojkotin.

Është koha për një rivlerësim urgjent që vendos drejtësinë dhe ekuilibrin në qendër të qasjes sonë ndaj marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Trendi i kohëve të fundit i ndëshkimit të Kosovës dhe duke i dhënë zemër Vuçiqit gjithnjë e më autokratik, po na çon më thellë në një cikël dhune, paqëndrueshmërie dhe keqdashjeje, ndërsa drita në fund të tunelit të normalizimit, dhe anëtarësimit në BE për të dyja palët errësohet gjithnjë e më shumë.

Vlen gjithashtu të kujtojmë se Serbia ka një PBB prej 63 miliardë dollarësh dhe një buxhet ushtarak prej 1.4 miliardë dollarësh krahasuar me PBB-në e Kosovës prej 9.4 miliardë dollarësh dhe shpenzime ushtarake pak më shumë se 54 milion dollarë. Kjo nuk është një garë e barabartë dhe qasja jonë duhet të njohë cenueshmërinë dhe nevojën e Kosovës për ndihmë.

Së pari, ne duhet të forcojmë masat e sigurisë. Mbretëria e Bashkuar, si anëtare e Kuintit, duhet të marrë një rol më aktiv në dialogun e paqes ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Pasiviteti ynë aktual është i paqëndrueshëm përballë një situatë kaq të paqëndrueshme. SHBA dhe BE duhet

gjithashtu të marrin një qëndrim të vendosur kur i drejtohen udhëheqjes së Serbisë për rolin e tyre në nxitjen e destabilitetit, përafrimin me Putinin dhe tendencat gjithnjë e më autokratike brenda dhe jashtë vendit. Presidenti Vuçiq nuk duhet të përjash-tohet nga kritikantët. Në fakt, takimi i tij i parë mëngjesin pas vrasjes së policit ishte me ambasadorin rus në Serbi.

Arritja e një ekuilibri midis stimujve dhe pasojave është jetike për të siguruar llogaridhënien dhe përparimin. Përgjegjësia e shpejtë dhe e barabartë për aktet e agresionit është thelbësore për të dekurajuar dhunën e mëtejshme duke zbutur çdo nocion qetësimi. Këta 'qiramarrës' bazë të negociatave duhet të mbahen mend dhe të riintegrohen në qasjen kolektive të Quint-it.

Ne gjithashtu duhet të negociojmë nga një pozicion i forcës duke rritur masat e parandalimit dhe duke shtuar 4,500 trupat e KFOR-it. Gjithashtu, Mbretëria e Bashkuar duhet të ribashkohet me forcën paqeruajtëse EUFOR në Bosnje kur ajo të rinovohet në muajin nëntor. Nëse Rusia vë veton për përtëritjen e saj, NATO duhet të jetë gati të vendosë

një forcë alternative paqeruajtëse në Bosnje për të shmangur një vakum pushteti.

Çdo përshkallëzim në Ballkan do të kishte efekte valëzuese në të gjithë Evropën, duke e bërë të domosdoshme forcimin e masave të sigurisë. EULEX-i duhet të kryejë një hetim të paanshëm, pa ndërhyrje politike, për të hedhur dritë mbi përfshirjen e autoriteteve apo akterëve të Beogradit në vrasjen e policit kosovar dhe në bllokadat e supozuara të orkestruara të rrugëve. Nëse zbulohet se Beogradi është i përfshirë në ndonjë mënyrë, duhet të ketë pasojat të shpejta dhe të fuqishme. Për më tepër, KFOR-i duhet të ndajë informacionin mbi depot e armëve dhe lëvizjet me vendet anëtare pjesëmarrëse për të luftuar në mënyrë efektive aktivitetet ilegale.

Ne duhet të promovojmë dialogun dhe mirëkuptimin ndëretnik. Qeveria e Kosovës duhet të skicojë përkushtimin e saj të palëkundur për të mbështetur komunitetet serbo-kosovare, duke siguruar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në demokraci pa ndërhyrje të pajustificuara të huaja. Angazhimi i pesë shteteve të BE-së që nuk e njohin sovranitetin e Kosovës do të ofrojë një shtytje të konsiderueshme në trajektoren e Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe NATO, duke forcuar përkrahshëmërinë e integritetit të saj territorial.

Në fund, duhet të hulumtohet krijimi i një aleance sigurie ndërmjet SHBA-

së, Britanisë së Madhe, shteteve të tjera anëtare të NATO-s dhe Kosovës derisa Kosova të arrijë anëtarësimin e plotë në NATO. Një marrëveshje e tillë do të adresonte shqetësimet e menjëhershme të sigurisë dhe do të hapte rrugën për stabilitet afatgjatë në rajon.

Gjendja aktuale në Kosovë dhe Serbi kërkon një përgjigje të vendosur dhe burrështetase. Mosndëshkimi për aktet që ushqejnë përbuzje për rregullin dhe rendin nuk mund të tolerohet. Përgjegjësia, dialogu i hapur dhe masat e forta të sigurisë janë të domosdoshme për të garantuar stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Është koha që Britania e Madhe të miratojë një politikë më fortë në Ballkan. Ne nuk jemi më të kufizuar nga konsensusi i BE-së dhe shtetet mosnjohëse, dhe duhet të jemi më inovativ në diplomacinë tonë, kështu që ne duhet të gjejmë jo vetëm zërin tonë, por edhe shtyllën, të ndalojmë së qëndruari mënjane dhe të ndërmarrim veprime aty ku ne kemi për detyrë të mbështesim aleatët tanë.

Ne zotërojmë suksesin dhe dështimin e mundshëm të Kosovës dhe kemi më shumë përgjegjësi se shumica për t'u qëndruar pranë atyre dhe për të siguruar që të mos shohim një kthim në brutalitetin e viteve 1990.

Dështimi nuk është një opsion në epokën e diplomacisë parandaluese dhe duhet të ndërmerren veprime tani për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm dhe për të siguruar një të ardhme paqësore për të gjithë në Ballkan.euronews.al

PSE EDI RAMA NUK HESHT DOT PËR KOSOVËN

ARMAND SHKULLAKU

Në mungesë të qëndrimeve të qarta dhe pamundësisë për t'u rreshtuar krahas Kosovës në këtë peirudhë të vështirë, ndihma më e madhe që Edi Rama mund t'u japë shqiptarëve atje, është heshtja. Por duket se kryeministri shqiptar, diçka të tillë e paska të pamundur.

Ai i ka lënë pa tekst të gjithë, kur në një intervistë për prestigjiozen britanike, Financial Times, e ka cilësuar Kosovën “një pikë të nxehtë” dhe veriun e saj “tokë të askujt”. Një konsideratë e tillë, pikërisht në momentin kur Kosova u gjend përballë një sulmi terrorist të planifikuar nga Beogradi, krijon idenë e një konflikti në një zonë të papërcaktuar dhe, gjithnjë sipas Ramës, për këtë është e nevojshme një konferencë ndërkombëtare, madje në ndërkohë, vënia e këtij territori nën kontrollin e trupave të Natos.

Shumë politikanë dhe analistë, në Kosovë e Shqipëri, kanë mbetur të shokuar nga “bomba” e radhës që ka lëshuar kryeministri shqiptar. Kosova nuk është një pikë e nxehtë dhe nuk ka pjesë të saj që janë “tokë e askujt”. Kosova është shtet sovran dhe i pavarur, i njohur si i tillë me kufijtë që ka sot nga fuqitë perëndimore dhe Gjykata Ndërkombëtare, është demokracia funksionale më e vlerësuar në rajon, është palë në negociatat



me Serbinë dhe jo një territor i nxehtë që synon të definojë shtetësinë e saj.

Nisur nga qëndrimet e Ramës, si ato të dikurshmet për shkëmbim terri-tosh apo Ballkanin e Hapur, ashtu edhe ato më të vona si drafti i pakërkuar për asociacionin, anulimi i mbledhjes së dy qeverive, propozimi për futjen e KFOR në veri kur më parë këtë e kishte cilësuar si skenarin më katastrofik për Kosovën, e deri tek ideja absurde për një konferencë ndërkombëtare për të vendosur për “tokën e askujt”, është e vështirë të kuptosh se përse kryeministri i Shqipërisë nuk zgjedh më mirë të heshtë.

Përse kohë e ka të pamundur të mbajë qëndrime si Kroacia, vend i NATO-s dhe BE, përse kohë nuk flet dot si palë me Prishtinën por si dikush mbi palët, përse kohë nuk e përmend dot direkt Serbinë dhe Vuçiçin si shkak-tarë të tensioneve në Kosovë, përse kohë nuk ngre zërin për dhunën ndaj shqiptarëve në Luginë, atëherë përse duhen dhe për çfarë shërbejnë qëndrimet e kryeministrit të shtetit shqiptar?

Pjesa më e nervozuar dhe më e prekur nga qasja e Edi Ramës në raport me Kosovën, por edhe kundërshtarët e tij në Shqipëri që duan t'i shfrytëzojnë këto qëndrime për luftën e brendshme politike, e kanë përgjigjen në majë të

gjuhës: i shërben interesave serbe, është tradhëtar. Një pjesë tjetër e lidh ose me injoracën e tij për rajonin ose me maninë për protagonizëm, edhe kur këtë nuk ia kërkon askush.

Në fakt, gafat e pafalshme të Ramës në raport me Kosovën, nuk janë produkt as i ndonjë rekrutimi nga Beogradi dhe as ilaç për të kuar maninë e tij të madhështisë. Ato janë pasojë e dështimit të një strategjie të mirëmenduar më parë por që tani po thërrmohet, për shkak të rezistencës që dëshmoi Prishtina në vazhdimësi dhe Albin Kurti në veçanti. Rama dhe Vuçiç, të njohur si autokratë që kontrollojnë të gjitha pushtetet në vendet e tyre, kanë tentuar të “blejnë” mbështetjen ndërkombëtare duke u paraqitur si liderët e shqiptarëve dhe serbëve, që kishin në dorë menaxhimin e krizave dhe për rrjedhojë edhe zgjidhjen e tyre.

“Rama, për një kohë të gjatë u përmbyt nga përfshirja në konfliktin e Kosovës, në vend të kësaj, ai ndërtoi lidhje të përzemërta me Beogradin ndërsa kërkonte të bënte progres në rrugën e anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor”, shkruan Financial Times. Të dy liderët e provuan me shkëmbimin e territoreve, pastaj me Ballkanin e Hapur, por strategjia për të marrë fatet e rajoni në dorë u rrëzua. Qëndresa e Albin Kurtit, e nx-

orri Ramën “të papunë”, sepse duke humbur peshën në Kosovë, ai nuk i duhet më as Vuçiçit.

Mbetja pa një rol kyç, në një kohë kur vëmendja e SHBA dhe BE është tepër e madhe ndaj Kosovës, e nxjerr jashtë loje strategjinë e Ramës si lideri që pretendonte të arrinte mes serbëve dhe shqiptarëve atë që francezët dhe gjermanët bënë pas Luftës së Dytë Botërore.

Ftohja e mundshme me Vuçiç, si pasojë e pamundësisë për të ndikuar në Prishtinë, e ka prishur balancën e strategjisë së dikurshme Beograd-Tiranë. Ky çrregullim si dhe dështimi i nismave të mëparshme (shkëmbimi i territoreve dhe Ballkani i Hapur) ka bërë që edhe liderët perëndimorë ta konsiderojnë kryeministrin shqiptar si një faktor të dorës së dytë në planet e tyre për rajonin.

Dhe Edi Rama mund të durojë gjithçka, por jo këtë. Prandaj ai nuk mund të heshtë. Deklaratën shock në Financial Times do ta pasojnë të tjera, ku ashtu si më parë, do të lexohet qartë ngërçi që ai ka: edhe të joshë Vuçiçin edhe të rifitojë vëmendje në skenën ndërkombëtare. Çështja është që për këtë, nuk ka pse të paguajë Kosova. lapsi

ENVER ROBELLI

A DO TA GËLLTISË PERËNDIMI EDHE KËTË FARSË TË VUÇIÇIT?

Propaganda e qullët serbe, manipulimet, parodia juridike, trajtimi i terroristëve si figura të rëndësishme publike, arrestimi dhe lirimi i menjëhershëm i kriminelit Milan Radoiçiç nuk paraqesin asnjë befasi. E habitshme do të ishte nëse Perëndimi e gëlltit edhe këtë farsë të Vuçiçit. Një kronikë e rrenave të parapolitikës serbe - nga luani i kopshtit zoologjik të Sarajevës deri te gomat e djegur në Dubrovnik.

Kur (03.10.) u arrestua Milan Radoiçiç (ose së paku u tha se u arrestua), disa diplomatë perëndimorë në Beograd reagan të lehtësuar. Një ditë më vonë, pra sot (04.10.), Radoiçiç është njeri i lirë, i liru nga “drejtësia serbe”, dhe ndoshta ndonjë diplomat tani është i mërziutur, sepse ra në ujë iluzionin që Serbia e ka ndërmend t'i ndriçojë rrethanat e sulmit terrorist ndaj Kosovës më 24 shtator 2023 dhe të dënojë kryerësit e krimit. Që nga ajo ditë Serbia është demaskuar (sërisht) faqe botës si sponsorizuese e terrorizmit. Përpjekjet e propagandës së Beogradit janë shtuar me qëllim të përhapjes së mjegullës, manipulimit, gënjeshtrove. Armët e konfiskuara nga Policia e Kosovës ngjallin dyshime serioze se banda e Radoiçiçit është furnizuar nga ushtria

serbe apo nga nënkontraktorë të tjerë të shtetit që punonin për Radoiçiçin. Për të zhdukur këtë gjurmë, drejtësia serbe e kontrolluar nga Vuçiçit tha se Radoiçiç i ka blerë armët në Tuzla të Bosnjë-Hercegovinës.

Qëllimi është evident: të njollosen Bosnja dhe boshnjakët! Sepse Tuzla gjendet në federatën boshnjakokroate, jo në entitetin serb. Sipas propagandës serbe, paramilitarët e Radoiçiçit u furnizuan me armë në Bosnjë, ndërsa Policia e Kosovës paskësh armë serbe (“prej nga këto armë?”, pyet me një zë kori i propagandistëve serbë). Tre terroristët e vrarë u varrosën si heronj, njëri prej tyre në Vërnjačka Banjë, ku fansat e Cërvena Zvezdës dolën në rrugë me pishtarë të ndezur. Në varrim u shfaq edhe Milan Radoiçiç.

Ndërkohë Vuçiçit dhe kanalet e tij mediatike emetuan zërin e një “dëshmitari të mbrojtur”, i cili - pak a shumë - tha: “Isha rrugës duke ecur dhe rastësisht pashë disa njerëz të armatosur, i pyeta a keni nevojë për ndihmë, kur befasi u shfaq Policia kosovare dhe nisi të gjuante ndaj nesh dhe ne filluam të iknim...”. Tingëllon si përrallë dhe është përrallë. Në krejt këtë komedi parapolitike serbe, po mungon vetëm Danica Marinković, gjykatësja hetuese e administratës

pushtuese serbe në Prishtinë, e cila pas masakrës së forcave serbe në Reçak përpiquej të manipulonte të vërtetën.

Këto ditë po përjetojmë një kthim të Serbisë në vitet '80 dhe '90, kur propaganda serbe arsyetonte çdo krim ndaj të tjerëve dhe fabrikonte krime ndaj serbëve. Më 18 nëntor 1991 ushtria jugosllave e shndërruar në armatë serbomadhe pushtoi qytetin barok kroat Vukovar. Ndërsa ushtarë, paramilitarë e çetnikë masakronin civilë kroatë (dhe disa shqiptarë) në periferi të qytetit, radiotelevizioni i Serbisë RTS jepte lajmin e rrejshëm se forcat kroate kanë masakruar “41 fëmijë serbë”, kufomat e të cilëve qenëshin gjetur në shkollën fillore në Borovo Sello.

Kur bota e civilizuar u trondit nga sulmet serbe e malazeze ndaj Dubrovnikut më 1991, mediat e Beogradit citonin një oficer serb, i cili thoshte se tymi që dilte nga qyteti i vjetër i Dubrovnikut nuk ishte pasojë e sulmeve, por tym gomash që paskëshin ndezur kroatët për të mashtruar botën. Gjatë rrethimit të Sarajevës nga ushtria e serbëve të Bosnjës, një gazetare e kanalit televiziv serb “S” raportoi se “ekstremistët myslimanë” po i hedhin fëmijët serbë në kafazet e luanëve në Kop-

shtin zoologjik të Sarajevës. Për kanalin “S” atëbotë punonte edhe një huligan i ri politik nga Beogradi me emrin Aleksandar Vuçiç.

Si gjatë luftërave të viteve '90, edhe tani, pas sulmit të armatosur kundër Kosovës, propaganda e Beogradit nuk ka ndryshuar. Por do të ishte e habitshme nëse bashkësia ndërkombëtare do ta gëlltiste edhe këtë farsë juridike e politike të Vuçiçit sa i përket bandës së Milan Radoiçiçit. Ky rrezik ekziston.

Përzgjedhja e avokatit të Radoiçiçit përshatet si gur në mozaikun e madh të propagandës. Një “përzgjedhje e natyrshme”, shkruan gazeta “Danas”. Goran Petronijević, gjyqtar në Pejë gjatë luftës së Kosovës, në maj të vitit 2000 i dënoi 143 shqiptarë të Kosovës me 1632 vjet burg për shkak të “veprës penale të terrorizmit”. Mandej, ky gjykatës në shërbim të regjimit të Slobodan Milosheviçit i dënoi (në mungesë) me nga 20 vjet burg Bill Clinton, Madeleine Albright, Jacques Chirac, Gerhard Schröder, Tony Blair, për shkak të bombardimit të Jugosllavisë serbo-malazeze. Pasi ra regjimi i Milosheviçit, Petronijević u mor me avokaturë dhe klientët e tij ishin, mes të tjerash, kriminelit i luftës Radovan Karaxhiç, shefi i sigurimit shtetëror Radomir Marković, këngëtarja Svetlana Razhnatović (“Ceca”)

etj. Petronijevići e quan veten “biograf zyrtar të Ratko Mladiçit” dhe sipas Radios Evropa e Lirë ai ka vëzhguar “zgjedhjet” që Rusia ka organizuar në territoret e pushtuara ukrainase.

Në maj të vitit 2020 mediat serbe njoftuan se Petronijevići u grushtua nga një grup burrash në një restorant të Beogradit. Më 1991 Slobodan Milosheviç pati thënë: “Nëse nuk dimë të punojmë mirë, së paku do të dimë të rrihem”. Detyrë e Petronijevićit tani është të “dëshmojë” se Milan Radoiçiç hyri në Kosovë duarthatë, bashkë me paramilitarët e tij duarthatë, të cilët duarthatë vranë një polic të Kosovës dhe duarthatë u strehuan në një manastir të Kishës Ortodokse Serbe, ndërsa qëllimi i tyre paskësh qenë që duarthatë të armatosin popullin duarthatë serb në Kosovë.

Në këtë mision ai mund të llogarisë në ndihmën e shtetit. I pari i shtetit serb disa herë e ka lavdëruar Radoiçiçin si trim. Petronijevići duket se ka lidhjet e duhura me drejtësinë dhe me politikën. Mediat serbe botuan sot (04.10.) fotografi ku Petronijevići shihej në piknik me shefin e Prokurorisë së Lartë në Beograd, Nenad Stefanović, një adhurues i partisë në pushtet SNS.

ANDI BUSHATI

Kushdo që e ka dëgjuar dy ditët e fundit Edi Ramën ka mbetur ndoshta i befásuar nga ndryshimi i kursit patriotik në fjalorin e tij. Ai, për herë të parë kritikoi vendimin e Beogradit për të mbajtur zi kombëtare për paramilitarët që ushtruan dhunë dhe vranë një polic pranë Zveçanit. Ai shkoi edhe më tej, duke shpallur se që një premierë në këtë dekadë të sundimit të tij, që Shqipëria po mbante një linjë të kundërt nga ajo e BE-së, e cila nuk e dënoi, sipas Ramës, me forcën e duhur këtë akt.

Në një shikim sipërfaqësor dhe të pavëmendshëm duket sikur kryeministri ynë e ka bërë ndarjen midis viktimave dhe agresorëve dhe ka vendosur të marrë anë në favor të të parëve.

Por, në fakt thelbi nuk është ashtu siç duket nga forma. Në konferencën e shtypit në kryeministri, ai nuk e fshehu dot çoroditjen e njerëzve që kanë diçka për të fshehur. Në qëndrimin e tij kishte një disproporcion absurd, mes goditjes së fortë që i bënte hallkës më të dobët në Bruksel, zëdhënësit të BE, dhe druajtjes për të etiketuar Vuçiçin, si ideator të sulmit kriminal të 24 shtatorit.

Aty kishte inkoherenca qesharake. Kur BIRN e pyeti nëse ishte i gatshëm të negocionte mes Kosovës dhe Serbisë, ai tha se kjo që e pamundur, pasi si kryeministër i Shqipërisë e konsideronte veten palë. Ama kur iu desh të përgjigjej nëse ia kishte treguar propozimin e vet për asociacion, Prishtinës dhe Beogradit, ai u mbrojti duke argumentuar se kishte paraqitur një propozim mbi palët.

Ai pohoi se pavarësisht ngjarjes së rëndë që ndodhi në Banjškë do i vazhonte takimet bilaterale me Vuçiçin, ndërkohë që për një gjë shumë më të papërfillshme sesa kaq, ai anuloi mbledhjet mes dy qeverive me



Kurtin.

E gjithë kjo çoroditje dhe ky varg inkoherencash rridhte nga dyzimi për të bërë bashkë dy gjëra të pamundura: fjalorin prej burri patriot, me legenlëkun prej vasali të Vuçiçit.

Sepse këtë 28 shtator, Edi Rama ka lëshuar nga goja një tezë që do të mbahet mend gjatë, si një thikë pas shpine për Kosovën e që deri më tani nuk ka guxuar ta artikulojë asnjë politikan i lartë shqiptar. Ai propozoi që trupat ndërkombëtare të KFOR-it të merrnin nën kontroll veriun, një territor me shumicë serbe, po që gjendet

në sovranitetin ekskluziv të Republikës së Kosovës. Kjo kërkesë e rihap diskutimin për veriun, që dikur Rama bëri plane për të trajtuar si një territor të shkëmbyeshëm dhe shpie ujë në mullirin e të gjithë kritikëve të Albin Kurtit, që e akuzojnë atë se e ka këtë pjesë jashtë kontrollit.

Por, më e bukura e kësaj lajthitje të kryeministrit ishte se vetëm pak kohë më parë ai mendonte krejt ndryshe. Me një profesionalizëm të lavdërueshëm për memorien dhe shpejtësinë e reagimit, gazetarja e A2 CNN, Fiorela Beleshi, i kujtoi Ramës se jo më larg se 19 Qershori i këtij

viti, ai pati shkruar se vendosja e KFOR-it në Veri do të thoshte humbje e kontrollit të shtetit mbi territorin.

Pra, a po kërkonte Rama me propozimin e tanishëm të sanksiononte tkurrjen e kufijve të Kosovës? Pse ky ndryshim radikal vetëm në tre muaj? Çfarë e justifikonte këtë piruetë, që nëse nuk ishte idiote, mund të quhej me plot gojën e poshtër?

Ata që i hedhin një sy mediaeve të Beogradit e kanë përgjigjen. Propozimin 180 gradë të ndryshëm me atë që mendonte dikur, kryeministri e bëri

pasi të njëjtën gjë e artikuloi, një ditë më parë, Vuçiçi.

Pra ai s'po belbëzonte, as më pak e as më shumë, sesa si papagall i presidentit serb. Prandaj, për të kamufluar me sa mundej këtë akt, që do të ishte i turpshëm për çdo njeri normal, ai u rek ta kamufltojë atë me një gjuhë të rënduar patriotike.

Kritikat për mbajtjen e zisë në Beograd dhe shpallja gjoja e ndarjes nga linja e BE-së, ishin maskimi formal për t'u bashkuar në thelb me të njëjtën linjë si Serbia.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



Akoma nuk keni një website?

The Albanian

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

 **020 7018 7929**

 **073 4066 5946**

NDUE DEDAJ

Është e njohur shprehja “Lufta për të mbetur njeri”, si titull librash, përfshi dhe i një përmbledhjeje artikujsh, intervistash dhe fjalimesh për demokracinë, të shkrimtarit dhe politikanit Pjetër Arbnori, që për të mbetur njeri iu desh sakrificë prej 28 vitesh burg politik dhe moskompromisi me padrejtësinë as në demokraci. Edhe pse nuk mund të ketë në jetë një luftë më të madhe sesa ajo për të mbetur njeri, për çudi duket se tashmë është një tjetër “luftë” që na ka kapluar marrëzisht, ajo për të mbetur në histori!? Mund të duket e pakuptimtë, megjithatë është shpërfaqur një realitet i ri social, ku njerëzit përipiqen me të gjitha mënyrat dhe mjetet për t’u arkivuar në histori, që të mos shkojnë ashtu hupët në të ardhmen kur të mos jenë, por të kujtohen me pahir.

Politikanë të rëndësishëm dhe shtetarë të lartë, që u janë shpopulluar krejt malësitë në Jug e në Veri i kanë vënë syrin historisë, edhe pse ajo, në vend që t’iu ngre piedestale, do t’i ndëshkojë, pasi ata nuk ndoqën politika për ta frenuar e ndaluar këtë zhblimje antihistorike. Disa herë në fushata elektorale është thënë nga kandidatë të ndryshëm për deputetë, kryebashkiakë e gjer kryeqeveritarë: “Unë punoj për historinë”, që emri i tyre të përmendet brez pas brezi. Mirëpo ky është vetëm një iluzion. Një ëndërr e bukur me sy hapur. Kujtesa e historisë është krejtësisht tjetër. Ajo mban shënim jo ëndërrat e një nate vere, por realitetet.

Veçir të Shkodrës, Mehmet Pashë Bushati (shekulli XVIII) i ishte harruar dhe emri në treqind vjet, por “Ura e Vezirit” në Kukës e ndërtaur prej tij thirret kështu dhe sot e kësaj dite, edhe gjysmë shekulli mbasi është përmblytur nga hidrocentrali i Fierzës. Ia hoqën Mbretit të shqiptarëve gjithçka, përfshi dhe të drejtën për të hyrë në Shqipëri nga Kongresi i Përmetit, ama urën mbretërore mbi Mat, ndërtaur më 1927, populli vazhonte me e quajti “Ura e Zogut”. Askush më Kuçovën nuk e quan “Qyteti Stalin”, kurse qyteti “Bajram Curri” vazhdon në çdo kohë me të njëjtin emër. Kjo është historia.

Ata që i kanë dy para mend në krye veç me historinë nuk “ngatërrohen”, pasi vetëm aty nuk mund ta hapësh vendin vetë. Se ka dalë dhe kjo puna e rishkrimit të historisë dhe ku i dihet, ata që janë mund të dalin e disa të tjerë do të hyjnë pa iu marrë leje historianëve të indoktrinuar. Si, për shembull, disa krerë të malësive shqiptare.

Bajraktarët “reaksonarë”, misionarë të flamurit të Pavarësisë

Dedë Gjo Luli, nga paria e Hotit, e ngriti flamurin shqiptar në majë të Bratilës në Kelmend. Historia me të drejtë ia ka njohur meritat si askujt, por ai nuk ishte vetëm. Aty ishin dhe bajraktarët e malësive shqiptare, ku në një fotografi para flamurit të ngritur atë ditë shihet dhe djali i Kolë Tomës,



bajraktarit të Velës. Sot vërehet një gjuhë e kursyer kur flitet për veprën e shquar atdhetare të figurave të tilla, kurse në revistën “Hylli i Dritës” më 1937 shkruhej me stil panegjirik: Kol Toma e Ded Gjo Luli, i pari në Malci t’Lezhës, i dyti në Malci të Madhe, qenë dy burra të thatë e të gjatë, të idhtë e kuvendçar, me mende të hollë e të pakreni, burra beset e me shumë burni, që kanë ma të madhin meritim e ma të shkëlqyshmen lumni në dëshmorët e Shqypnis, se qenë ma të parët trima që filluen veprimet për lirinë e Atdheut. Kjo është dhe dekorata më e lartë për ta.

Merita historike është se bajraktarët u ngritën nga flamuri i vogël lokal i bajrakut të tyre tek ai kombëtar. Ky është një hap i madh rilindës. Si në majë të Bratilës - Deçiq më 6 prill 1911, si në Fan e Kimzë të Mirditës më 26 prill 1911, të njëjtët protagonistë - bajraktarët dhe krerët e tjerë të maleve. Në të dy rastet nuk u ngrit flamuri i krahinave, por ai i Shqipërisë. Kjo ishte vetëdija kombëtare e bajraktarëve dhe krerëve në përgjithësi.

Preng Marka Prenga, bajraktari i Oroshit për një gjysmë shekulli, njëherësh kryebajraktar i Mirditës, me merita të mëdha si prijës popullor dhe luftarak, ende vazhdon me qenë i “munguari” historisë. Ai këshillohej gjithnjë me Abat Prend Doçin për punët e luftës dhe të paqes, kuvendet dhe flamurin. Është dekoruar më 1962 me medaljen “Për veprimtari patriotike”, është shkruar ndonjë monografi për të në kohën e sotme, por ky flamurtar i pazakontë nuk është vënë në pedestalin e merituar. Ngaqë nuk është rishkruar historia dhe shumë ngjarje historike ende kundrohen bardh e zi. Teksa rishkrimi i saj bëhet në Tiranë, pasi atje janë arkivat, institutet kërkimore-shkencore, historianët etj. Ka gjasë që bajraktarët ende mbajnë mbi vete hijën që ua lëshoi Partia e Punës. Mëkati i tyre që se ata nuk e deshën Partinë Komuniste dhe kjo i ndau gjërat...

Historiografia e djeshme ka qenë ideologjike dhe ka ecur hapur me paragjykim. Kështu nëse njëri nga tribunët e Pavarësisë, me të drejtë njihet si hero kombëtar dhe krejt Malësia e Madhe mban titullin “Nderi i Kombit” edhe prej tij, figura të tjera të

dorës së parë si ai nuk janë sot në muze, në tekstet e historisë, guida etj., paçka se ka filluar të ketë një optikë tjetër sa i përket Preng Calit, një hero i gjallë i trojeve shqiptare. Pa hequr paralele mes Dedë Gjo Lulit të flamurit të Bratilës, që u vra në pabesi nga malazetë më 1915 dhe Prengë Marka Prengës së flamurit të Kimzës, ky i fundit nuk njihet kombëtarisht, pasi nuk kishte se si regjimi i djeshëm të shpallte figurë kombëtare një atdhetar nga Oroshi reaksionar i Gjomarkajve!? Për më tepër, Prengë Marka Prengës, që kishte udhëhequr kryengritjet e Pavarësisë për çlirim të Lezhës, në krye të ushtrive mirditase, mbas Luftës së Dytë Botërore i futet në burg politik njëri nga djemtë. Po për arsye ideologjike ende nacionalisti i njohur Muharrem Bajraktari i Lumës nuk është ndriçuar si figurë historike e kohës së tij, përpos se nga botimet e autorëve kuksianë. Për kontributin në krijimin e Xhandarmërisë shqiptare, nga Mbreti Zog që dekoruar me “Urdhrin e Skënderbeut” etj. Ai ishte njëherësh antifashist dhe antikomunist. Janë lënë jashtë historiografisë zyrtare jo vetëm figura të rëndësishme politike e shtetërore komplekse, por dhe ngjarje si masakra e Buzëmadhes e shtatorit të vitit 1944, kur partizanët e Brigadës V Sulmuese vranë 21 banorë lumjanë, që më pas u quajtën viktimat të Luftës. Për mendimin tonë, barra e historiografisë është të shkoqisë pikërisht kompleksitetin e këtyre figurave dhe ngjarjeve, duke i dhënë hakun secilës, pa i parë ato tashmë: o vetëm bardhë, o vetëm zi. Kemi frikë ta ngrëmë Muharrem Bajraktarin se na “bie” Bajram Curri, me që historia i pati vënë dikur në pozita kundërshtarë?! Po sa përplasje e përballje të tilla, njolla të njërit apo të tjetrit mund të kemi përgjatë historisë? Protagonistët e historisë nuk janë “produkte” laboratorike, që mund t’i kemi të gjithë si Luigi Gurakuqi...

Piedestale të rremë dhe piedestale që presin

Për të kuptuar se sa e dyshimtë është historiografia e deritashme lidhur me ngjarjet e shekullit XX, mjafton një kundrajë në lojërat e Sigurimit të Shtetit pas Luftës, ku ka “heronj të

heshtur” të vrarë nga vetë arma e dashur e Partisë!? Edhe në kohën e demokracisë, krahas vlerësimit të disa figurave historike të ndaluara politikisht, janë vënë në fokus dhe të tjerë të pamerituar, prej ndikimit të politikës pragmatiste. Mirëpo nuk është e sigurtë se keta të rremët do t’i mbijetojnë historisë. Më të vërtetë që ekziston një si aksiomë që duhet respektuar çdokush që ra për një ideal, po këtu problemi është pikërisht ideali, cili ishte i tillë dhe cili jo.

Heronjtë e kauzave të mëdha, misionarët e shquar të progresit njerëzor nuk ka nevojë t’i identifikojnë klanet e ndryshme, pasi ata kanë zënë vend vetë në panteon. Përherë e më shumë flitet për Papa Klementin XI, po i bëhen buste e shtatore pas treqind vitesh në Tiranë, në Mërqi të Lezhës etj. Urojmë që kjo të ndodhë dhe me Imzot Prend Doçin, i cili ende nuk ka një shtatore publike në Mirditë, Shkodër apo Tiranë, edhe pse në kryeqytetin shqiptar shkollat e reja mbajnë emra politikane bashkëkohës, shuar vitet e fundit.

Këto ditë u përkujtua më Muzeun Historik Kombëtar folkloristi i shquar At Bernardin Palaj, njëri ndër sëndërtuesit e kolanës “Visaret e Kombit”, ndërkohë që figura të tilla deri vonë shiheshin si të kishës, kur ishte fjala për t’i nderuar e vlerësuar. Sa më shumë që t’i bëhet jehonë veprës studimore të Aleksandër Xhuvanit, Injac Zamputit, Rrok Zojit, Qemal Haxhihasanit, Emid Tedeskinit, Ramadan Sokolit, Aristidh Kolës etj., njerëzit jo vetëm që do të njihen me një elitë dijetarësh shqiptarë të rendit të parë, por dhe do të kuptojnë amatorizmin e disave që besojnë në “veprën” e tyre studimore (reformuese!) në lëmë të gjuhës, historisë, etnologjisë etj.

Njerëzit mirëpresin çdo nismë shkencore që synon t’iu shkojë punëve të historisë në themel. Është njoftuar se me 9 dhe 10 tetor Akademia e Shkencave do të organizojë në Tiranë dhe Mirditë një konferencë shkencore dyditore, kushtuar Shtetit të Arbërit (shteti i parë shqiptar, që i ka fillimet në vitin e largët 1190), me pjesëmarrjen e historianëve më të njohur. Profesori Shaban Sinani, gjatë një komunikimi që patëm me të rreth kësaj veprimtarie, na bëri me dije se është themeluar çmimi “Shuteriqi” për botime dokumentare, është shpallur konkursi dhe çmimet do të akordohen në ditët e konferencës.

Shpresojmë që në të njëjtën vazhdë, në të ardhmen nga Akademia e Shkencave të organizohen konferenca të tilla dhe për ngjarje të tjera madhore, kulmore në historinë e Mesjetës së vonë, si Kuvendi i Arbnit (1703).

Të futesh në histori përmes “veprës” prej kartoni...

Është edhe kjo mendësi provinciale.

T’i përcillesh historisë si autor! Për çudi, shumë individë që ndryshimi i sistemit politik ua ndërpreu karrierën si nëpunës të administratës, dhe pse nuk kishin asnjë lidhje me punët e shkencës, historisë, shkrimtarisë, u lëshuan pas kësaj “zeje” si të ishte një tokë djerr, duke sajuar libra që vetëm të tillë nuk mund të ishin. Meqë nuk kemi se si të bëjmë karrierë ndryshe për t’u leçitur nesër në histori, hajt o burra të shkruajmë libra!...

Është një nga shkaqet që njerëzit janë ftohur me librin, duke e braktisur jo pak atë. U krijua ideja se libra mund të bënte krejt mëhalla. Libromania është një problematikë që e kemi trajtuar qysh nga vitet 2000, kur kishte filluar të përvijohet si dukuri, që jo vetëm nuk ka ardhur duke u zbehur, përkundrazi është kthyer në një epidemi. Teoria e masave, masiviteti i përket monizmit dhe njerëzit vinin në pluralizëm të mbryjtuar me mendimin që njeriu mund ishte “specialist për gjithçka”. Ndërkohë që artet, letërsia, shkenca nuk janë asnjëherë sipërmarrje masive, ku mund të kontribuojë gjithsekush, por zhvillohen vetëm nga njerëz që kanë dhuntitë e duhura.

Grafomanët vazhdojnë të besojnë se me “veprën” e tyre po ndihmojnë në emancipimin e shoqërisë, se janë duke dhënë këtë apo atë mesazh etj!? Ata besojnë se nesër seria e veprave të tyre do t’i rreshtojë me korrifejët e kulturës shqiptare. Po Migjeni që nuk ka një seri veprash, por vetëm dy të tilla, si do t’ia bëjë? Po Lasgushi, gjithashtu vetëm me dy libra, “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”? Autorët seriozë nuk nisën asesi nga numri i librave, ata nuk i rreshtojnë ato në vitrinë si trofe, se i druhen “syrin të keq”. Më fjalë të tjera ata e dinë se krijimtaria nuk është sasi, por cilësi. Ky është thelbi i qenies së tyre krijuese. Paçka lirisë së botimit, askund në Europë nuk mund të prodhosh libra në këtë mënyrë, pasi në thelb ky nuk është botim, por shumëfishim dorëshkrimesh nga vetë autorët. Botimi është institucion më vete, që nënkupton editimin, redaktimin, korrektimin, promovimin, tregun e librit etj., prandaj janë shtëpitë botuese, po që shpesh as ato nuk e ndalojnë këtë prurje mbarëpopullore “veprash” pa kurrëfarë vlere, produkt i plagjiaturës dhe mediokritetit.

Nuk dimë se cila do të ishte lutja në këtë rast, që të na shpëtonte nga marrëzia e “shkrimtarisë”, pasi asaj lutjes së famshme ironike të Faik Konicës të para një shekulli për të mos shkruar, kur nuk kemi gjë për të thënë, as që ia kemi vënë veshin. Thua kaq hollë të na ketë njohur që atëherë, kur ende nuk kishim lindur, apo “vesin” për të shkruar të gjithë njerëzia vjer-sha e kishte vënë re te bashkëkohësit e tij?

Eh, grafomania dhe historia nuk takohen askund dhe asnjëherë...

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në
Google?!

**Për çdo
konsultim
mund te vini
në zyrat tona**

The **Albanian**

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**

Na kontaktoni:

**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**



**NE MUND T'U
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc

DITMIR BUSHATI

Bota u zgjua me imazhe të tmerrshme të sulmeve terroriste të Hamasit kundër Izraelit, të cilat me të drejtë u dënuan me ashpërsi nga e gjithë bota demokratike.

Edhe në Shqipëri, të gjithë krahët e politikës për pak minuta u bashkuan në mesazhet e tyre për dënimin e sulmeve terroriste të Hamasit kundër Izraelit. Mesazhet ishin thuajse të njëjta, në pajtim të plotë me praktikën e qëndrimeve të mbajtura nga Shqipëria për të tilla ngjarje.

Denoncohen me emër inspiruesit dhe autorët e sulmeve, sikundër shprehet solidariteti me familjarët e viktimave, popullin dhe shtetin e Izraelit. Padyshim roli i Shqipërisë në Lindje të Mesme është modest. Por qëndrimet politiko-diplomatike për këto ngjarje kanë një vlerë të pamohueshme në politikën e jashtme, pasi pasqyrojnë vlerat e popullit dhe vendit tonë. Për rrjedhojë, edhe renditjen përkrah aleatëve tanë të mëdhenj.

Ndërkohë që kanë kaluar dy javë prej sulmit terrorist të 24 shtatorit në Kosovë, të njëjtët krahë të politikës nuk gjejnë ende gjuhën e përbashkët për miratimin e një rezolute në Kuvendin e Shqipërisë, për dënimin e sulmit terrorist ndaj Kosovës dhe denoncimin me emër të inspiruesve dhe autorëve të sulmit, të cilët, i morën jetën në krye të detyrës policit Afrim Bunjaku.

Në memorien time do të mbetet gjithnjë e pashlyer seanca e Kuvendit të Shqipërisë, e 22 korrikut 2010. Teksa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpallte në mënyrë solemne vendimin e saj për përputshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, në Kuvendin e Shqipërisë u shfaq një ekran i madh, ku deputetët pa përjashtim ndoqën me emocion seancën maratonë të Gjykatës së Hagës. Nuk kishte ngjarje më të rëndësishme për kombin.

Ndaj, seanca parlamentare e 22 korrikut 2010 ishte në lartësinë që kërkonte ndërgjegjia kombëtare. Politika shqiptare dëshmoi dinjitet.

Nuk kishte kalendar, program apo agjendë parlamentare të planifikuar që mund ta konkurronte atë ngjarje historike. Simbolika e seancës parlamentare ishte e qartë: çështja kombëtare ka përparësi ndaj politikës të ditës.

13 vite më pas, sherret banale, gara me projekt-rezoluta dhe kërkesa për interpelancë, përçojnë mesazhin e papranueshëm se politika e vuvuzelave ka parakaluar çështjen kombëtare. Kjo nuk është në dinjitetin e politikës dhe as në nivelin e pritshmërisë së shoqërisë shqiptare.

TË BASHKUAR PËR KOSOVËN, TË MIRATOHET NJËZËRI REZOLUTA NË KUVENDIN E SHQIPËRISË



Kosova nuk është temë e politikës së jashtme dhe nuk mund të trajtohet as si temë e debatit të brendshëm politik. Kosova meriton të ketë vendin e saj të paprekshëm, pavarësisht rrethanave që prodhon politika e ditës. Nuk duhet të lejojmë që mungesa e vendosmërisë nga ana e Shqipërisë të trimërojë apo nxisë shtete ose grupime që kërkojnë zhbërjen e Kosovës.

Në rrethanat e tanishme politike dhe të sigurisë në Europë sulmi terrorist i 24 shtatorit ndaj Kosovës është një këmbanë e fortë alarmi. Sjellja e Serbisë ndaj Kosovës nuk është më një çështje politike, por një çështje serioze e sigurisë për rajonin dhe të ardhmen e Europës.

Zgjedhja nuk është më mes dështimit dhe suksesit të dialogut, por ndërmjet stabilitetit dhe një përshkallëzimi të mëtejshëm të dhunës. Kjo e fundit ka të ngjarë të ndodhë nëse tolerohet roli i Serbisë, si prishëse e stabilitetit rajonal.

Politika duhet të ngrihet në lartësinë e kërkesave të shoqërisë shqiptare dhe të miratojë njëzëri një rezolutë në Kuvendin e Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë ka plot burra e gra me dije dhe eksperiencë shtetërore që mund të hartojnë një dokument përbashkues që t'i qëndrojë stuhive të kohës.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të dënojë sulmet dhe provokimet e inspiruara nga Serbia kundër Kosovës, dhe të kërkojë bashkëpunimin e Serbisë me Kosovën, duke nisur nga dorëzimi i autorëve të sulmit dhe pranimit të një hetimi ndërkombëtar.

Kuvendi i Shqipërisë dhe qeveria shqiptare duhet të angazhohen në një përpjekje të mirëfilltë diplomatike për miratimin e një rezolute në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe emërimin e reporterëve të pavarur për të zbardhur rrethanat e kësaj ngjarje.

Duke pasur parasysh misionin dhe fushën e përgjegjësisë së Këshillit të Europës, praktikën e konsoliduar me trajtimin e rasteve të tilla, por edhe faktin që Rusia nuk është më pjesë e kësaj organizate pan-europiane në mbrojtje të lirisë dhe të drejtave të njeriut, Shqipëria duhet të kanalizojë energjitë politiko-diplomatike në funksion të përmbushjes së këtij objekti.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria duhet t'i lehtësojë Kosovës paraqitjen e provave dhe fakteve në forumet dhe organizatat ndërkombëtare, ku Kosova nuk ka qasje, në lidhje me

veprimtarinë e ekzekutorëve dhe urdhëruesve të sulmit terrorist.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të mbështesë punën e të gjitha institucioneve të Kosovës në funksion të zbatimit të ligjit, rendit dhe mbrojtjes së integritetit territorial të Kosovës, e të nxisë bashkërendimin e ngushtë të institucioneve të zgjedhura të Kosovës me partnerët strategjikë: SHBA-të, BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të riafirmojë angazhimin e palëkundur të vendit tonë si anëtar i NATO-s dhe kandidat për në BE, në mbrojtjen dhe promovimin e arkitekturës së sigurisë rajonale, të mbështetur nga SHBA, NATO dhe BE, qysh prej rënies së perdes së hekurit, e cila bazohet në mosndryshimin e kufijve, bashkëjetesën ndëretnike, mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut me fokus te pakicat, dhe pranimin e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Në këtë kontekst, partneriteti ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është strategjik për ne, stabilizues për rajonin dhe orientues për të ardhmen euro-atlantike.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë

duhet të denoncojë politikën e revizionimit të historisë dhe glorifikimit të kriminelevë të luftës dhe akteve terroriste nga Serbia, si pengesë për paqen, stabilitetin dhe ardhmërinë Europiane të rajonit.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të përshëndesë angazhimin e aleatëve në NATO për shtimin e trupave të KFOR-it, si garanci për përkrahshmërinë e perimetrit të sigurisë së Kosovës.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'i bëjë thirrje pesë shteteve anëtare të BE-së, katër prej të cilave anëtare të NATO-s, që të njohin pavarësinë e Kosovës si kontribut për besueshmërinë e BE-së si ndërmjetësuese; zbatimin e planeve europiane për rajonin; dhe në të njëjtën kohë, si mesazh ndaj Serbisë për të pranuar realitetin e pasluftës në ish Jugosllavi dhe për të ecur në drejtim të rrugës europiane.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'i bëjë thirrje vendeve anëtare të NATO-s për të përfshirë sa më shpejt Kosovën në Programin e Partneritetit për Paqe; dhe vendeve anëtare të BE-së për të filluar shqyrtimin e aplikimit për anëtarësim në BE.

KIM MEHMETI

KOSOVËN MË SHUMË E KA DËMTUAR RAMA SE SA VUÇIQI

Nuk është aspak e vështirë të dëshmosh se frika nga fryma anti-krim që solli me vete 'albinizimi', se zilia e urrejtja ndaj Kurtit, janë ato që aq e kanë verbëruar Kryeministrin e sotëm të Shqipërisë sa nga ajo verbëri ai nuk mund ta sheh që është bërë bashkëpunëtori dhe shërbëtori më i neveritshëm i Vuçiqit.

Për ta dëshmuar këtë mjafton të shohësh se si edhe në ditën e aktit terrorist serb ndaj Kosovës, ai nuk u ngrit dot të bënte as atë që e bënë serbët e arsyeshëm: ta dënonte këtë akt të dirigjuar nga Beogradi.

Apo mjafton t'ia numërosh veprimet e deritanishme 'strategjike' për të mirën e shqiptarisë, si për shembull: përkrahjen e 'Botës Serbe' nëpërmjet projektit për 'Ballkanin e Hapur; zbatimin e 'masave' ndërkombëtare ndaj Kosovës me anulimin e mbledhjes së dy qeverive; ripërsëritjen e kërkesës së Vuçiqit që, jo policia e Kosovës, por KFORI ta kontrollojë Veriun e saj; kërkesën për një konferencë ndërkombëtare që do e rishqyrtonte pozitën e Kosovës..., pra mjafton ta rikujtosh rolin e tij si zëdhënës i Vuçiqit, që ta kuptosh se ç'është ajo që atë e bënë të sillet si të ishte Dodiku i

'Republika Serpskës' e jo Kryeministri i Shqipërisë.

Nuk duhet të jesh ligjerues i ndonjë universiteti të njohur të botës që ta kuptosh se nëpërmjet Veriut të Kosovës, të Kishës Ortodokse Serbe në Mal të Zi, të 'Republika Srpska' në Bosnje dhe të rrymave proserbe në Maqedoni, Serbia i kontrollon pesë shtete të Ballkanit dhe mbetet me shpresë se nuk do mund t'i iket një konferencë të re paqësore ku do definohehin kufijtë e Serbisë së Madhe, e që përfundimisht do e 'stabilizonin' Ballkanin?

Dhe duhet të jesh mbi mesataren idiot që të mos e kesh kuptuar se Veriu i Kosovës është fitil që mund ta kall tërë Ballkanin, por se këtë zjarrëvnie mund ta bëjë vetëm Kisha Ortodokse Serbe nëpërmjet mjeshtërve të saj të luftës në Beograd.

Gjithashtu nuk është aspak e vështirë të shpjegosh pse Kryeministri i Shqipërisë bëri dhe pse është duke



bërë çmos, që Kryeministrin e sotëm të Kosovës ta shpërfaq para ndërkombëtarëve si burrshtetasin më destruktiv të Ballkanit.

Pra, ai donë ta shpallë Kurtin destabi-

lizues të Ballkanit sepse vetëm kështu mund ta mbrojë klasën e vet hajduktokrate politike, sepse e trishton e vërteta se të huajt gjithnjë e më shumë binden se shqiptarët kanë edhe bur-

rështetas të cilët më shumë kujdesen për vendin dhe popullin që drejtojnë se sa për shtëpitë e tyre të ndërtaura nga hajnia dhe se, tërë bota është duke e kuptuar se ta krahasosh burrshtetasin e mençur të quajtur Kurti, me 'Piktorin' batutaxhi që e drejton Shqipërinë, është njësoj si Çerçilin ta krahasosh me ndonjë drejtor cirku.

Po pra, është lehtësisht e shpjegueshme ndjenja se Kosovën me shumë e ka dëmtuar Kryeministri i sotëm i Shqipërisë se sa Vuçiqi, por megjithatë, ka diçka të pakuptimtë e të pashpjegueshme për autorin e këtij teksti: si është e mundur që Shqipëria e kohës së internetit, që mëmëdheu ynë që ka me mijëra mendimtarë, profesorë, doktorë shkencash..., të ketë mbetur aty ku ishte në kohën e pas zhbërjes së Perandorisë Osmane – të mos mund t'i dallojë 'Esat Pashët' e saj që do jenë heronj të Serbisë nga 'Ismail Qemalët' që dinë dhe duan të ndërtojnë shtet për shqiptarët.

GJERGJ EREBARA

Imagjinoje veten në spital pas pesë apo gjashtë vitesh. Je duke iu nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale. Një organ do të duhet të hapet dhe pastaj të qepet sërish. Ndërhyrje rutinë. Shpresoj të shkojë çdo gjë mirë për ty. Unë vetë, kam arsyet e mia të mos ndjehem rehat nëse do të isha në këtë situatë. Mjeku që është duke bërë ndërhyrjen ka gjasa nuk është i lumtur. Ai mundet të harrojë të bëjë diçka siç duhet ose e bën punën shkel e shko.

Arsyeja se pse ai është i palumtur nuk lidhet me ty si pacient, lidhet me qeverinë. Vetëm se pasojat ka gjasa që do t'i vuash ti, sepse qeveria përbëhet nga anëtarë të pasur, të pasur mjaftueshëm sa mund t'i lejojnë vetes të shkojnë në spitale private, brenda apo jashtë vendit, ku mjekët janë të lumtur me jetën e vet dhe nuk i detyron kush të rrinë aty ku janë.

Kjo është pak a shumë situata në të cilën ne do ta gjejmë veten në rast se qeveria vijon me planin e saj për të mbajtur me dhunë dhe kundër dëshirës së tyre mjekët e diplomuar rishitash në sistemin shëndetësor shqiptar. Mjekë dhe mjekë të palumtur përkundër një kërkese në rritje për shërbime shëndetësore. Sipas qeverisë, ata duhet të shërbejnë me detyrim për një numër vitesh para se të kenë të drejtë të fusin diplomën në xhep për të vajtur për të punuar aty ku u pëlqen, qoftë në spitale private në Shqipëri apo në spitale në vende të

tjera, fjala vjen, Gjermani.

Nuk më ngjan se është pespektivë shumë e këndshme. Imagjino, nëse je 25 vjeç, i aftë dhe plotësisht i trajnuar si mjek, dëshiron që minimalisht të shohësh botë me sy (dhe nuk mendoj se ka ndonjë shqiptar apo ndonjë qenie në planetin tokë që në moshën 25 vjeç nuk e ka menduar së paku disa herë që të ikë nga një vend në një tjetër), por je i detyruar të punosh në Shqipëri. Mundesh që me të vërtetë të mos kesh nga t'ia mbash. Me diplomën e mbyllur në kasafortë, ndoshta ia vlen të presësh që të punosh si mjek në vend që të punosh si pjatlarës. Por vështirë se ka ndonjë lloj mënyre që të të detyrojë ta bësh punën mirë, saktë, me pasion. Ti vetë e ke në dorë të mos e bësh. Në një sistem pune ku çdo minutë vlen, mundesh të shkosh pesë minuta me vonesë në sallën e operacionit, ose të rrëkëllish një birrë në pesë minuta pushim.

Kjo që po përpiqet të bëjë Rama me mjekët nuk është në fakt hera e parë në historinë e njerëzimit ku kontrata apo ligje duan t'i mbajnë njerëzit kundër vullnetit të tyre në një punë të caktuar. Në kohët e vjetra quhej skllavëri. Më vonë, në mesjetë, quhet bondage. Njerëzit, p.sh., nënshkruanin kontratë të tillë kur emigronin në Amerikë. Dikush i paguanë kalimin e oqeanit me anije, në shkëmbim, emigrantit detyrohej të punonte një numër vitesh te ferma e pronarit, za-

konisht 12 vjet. Britanikët tentuan pa sukses të përdornin një skemë të tillë në Australi. Ata transportuan atje të dënuar për krime të vogla, ose njerëz krejtësisht të pafajshëm dhe tentuan t'i përdorin si punëtorë krahu me kontratë. Por në një vend ku toka ishte e pafundme, punëtorët i hoqën qafe gardianët, disa raste thjesht duke ikur, në disa raste të tjera, duke i hequr qafe në mënyra më koherente, duke i vlarë.

Ekspertët dhe joekspertët e ekonomisë kanë debatuar gjerë e gjatë. Hipoteza kryesore është që skllavëria ofron punë më pak cilësore se sa punëtorët që hyn në marrëdhënie kontraktuale me vullnet të lirë. Në të gjitha rastet, këto lloj debatesh janë bërë për skllavëri të përdorur për punë të rëndomta. P.sh., për të punuar tokën. Adam Smith besonte se puna e skllavit nuk ka kurrfarë leverdishmërie. Njeriu për nga natyra dëshiron të hajë sa më shumë dhe të punojë sa më pak. Nëse pagesa nuk kushtëzohet me sasinë dhe cilësinë e punës, nuk vlen. Eric Williams besonte se në kushte të caktuara, kur ka tokë me bollëk, cilësia e punës ka rëndësi dytësore në raport me sasinë e për rrjedhojë, puna e skllavit është me leverdi. Në fakt, mendon ai, akumulimi i kapitalit nga puna e paguar e skllavit është ajo që i ka dhënë formë kapitalizmit siç e njohim ne sot. Të tjerë gjykojnë se skllavëria apo bondazhi si ky që po përpiqet të

përdorë Rama, nuk është një sistem i njëjtësuar, që është parë përgjatë historisë së njerëzimit siç e shohim ne sot. Skllavi mund të punojë mirë në rast se ka perspektivë të shpërblehet për këtë, fjala vjen, duke u bërë i lirë, ose duke u ushqyer apo paguar më mirë.

Natyrisht që në lidhje me mjekët, pyetja nuk është nëse ata do të punojnë pa dëshirë dhe do të punojnë keq, pyetja është se çfarë shërbimi mund të presësh nga një i ri që mbahet në punë kundër vullnetit të tij? Dhe me çfarë premtimi qeveria mundet t'i bindë ata të injorojnë kushtin poshtërues që u kanë imponuar dhe... ta dashurojë kontratën shtrënguese. Asgjë nga këto nuk vlen. Një mjek i detyruar kundër dëshirës së vet nuk do të të japë shërbim cilësor. Problemi që ne kemi me mungesë mjekësh mbetet njësoj i pazgjidhur.

Qeveria mundet me të drejtë të argumentojë se kostoja e arsimimit të një mjeku është kështu dhe ashtu dhe se mjekët e rinj kanë, qoftë edhe në rrafsh moral, detyrim për të shlyer në vendin ku janë arsimuar një pjesë të kostos që taksapaguesit kanë paguar për arsimimin e tij.

Por ky argument nuk vlen nëse nuk shihet në kontekst. Arsimiti i lartë publik në Shqipëri është i subvencionuar nga taksapaguesit në një masë të konsiderueshme dhe nga tarifatat në një

pjesë më të vogël. E pse dikush që është mjek duhet të ketë një kontratë të tillë shtrënguese, ndërsa një ekonomist, jurist apo tjetër, nuk e ka?! Për më shumë, problemi i largimit të mjekëve në Shqipëri është ana e dukshme e një krize më të gjerë. Shqiptarët po largohen në masë edhe pa qenë mjekë. Një krizë demografike me përmasa të përbindshme po akumulohet mbi kokat tona. Largimi i një kamarieri 25 vjeç heq nga skema e sigurimeve shoqërore një kontribues që duhet të punojë për pensionin e një pensionisti. Është një krizë që ka shumë gjasa që do të dënojë gjeneratën e sotme të shqiptarëve të mbyllin sytë me pensione edhe më të varfra se sa gjenerata e mëparshme.

Në vend që të gjejë zgjidhje të tilla jofunkionale si skllavërimi me kontratë i mjekëve të rinj, qeveria duhet të vrasë mendjen se pse shqiptarët po largohen. Dukshëm nuk është pabarazia ekonomike mes Shqipërisë dhe Gjermanisë. Një mjek në Gjermani mund të paguhet më shumë se sa në Shqipëri, por një i ri që shkon ta nisë nga zero atje do të duhet të paguajë qira. Në fund, pabarazia ekonomike vështirë se e shpjegon dëshirën e madhe për emigrim. Është më e mundur që mjekët dhe jomjekët po duan të ikin nga keqeverisja dhe korrupsioni. Për këtë nuk vlejnë kyçjet e diplomave në kasafortë. Reporter.al

KUR ILAÇI ËSHTË MË I KEQ SE SËMUNDJA

JUSUF BUXHOVI

Aspekti historik, diplomatik dhe politik i një prapaskene kundër shtetit të Kosovës, që siç u pa këto ditë me aksionin terrorist në Veri mbetet veprim aktiv i politikës së Beogradit në përputhje edhe me interesat e Rusisë për ruajtjen e sferave të interesit në rajon...

1. Aspekti historik

Nuk ka kurrfarë “konflikti të ngrirë” me Serbinë. Ky është vetëm një konstrukt mashtrues, që si metaforë (“krushqit e ngrirë” në vend të “krushqve të masakruar”), sa nga konceptet ideologjike, sa nga mosnjohja e historisë, së fundi, ka depërtuar edhe në politikën shqiptare.

Por, nga aspekti historik, e vërteta është ndryshe, ngaqë pikëpjekjet midis shqiptarëve dhe sllavëve, që si serbë shfaqen vetëm në shekullin nëntëmbëdhjetë kur identiteti fetar ortodoks do të kthehet në atë nacional, janë luftërat pushtuese të tyre për hapësirë, me pasoja të rënda për qenien shoqërore, kulturore dhe politike të shqiptarëve, të përcjella me etnocide, kulturocide dhe gjenocide të vazhdueshme dhe tragjedi, që siç u pa edhe këto ditë me sulmin terrorist serb në Veri, mbesin veprime aktive të politikës hegjemoniste të Beogradit në përputhje edhe me interesat e Rusisë për ruajtjen e sferave të interesit në rajon.

Mbi këtë platformë që u mbështet në “Naçertanjen” e Garashaninit të vitit 1844, janë të njohura veprimet pushtuese të Serbisë ndaj etnisë shqiptare edhe pasi shqiptarët ia dolën të shpallin shtetin e tyre të pavarur, që Konferenca e Ambasadorëve e Londrës, në vitin 1913 e njohu si të përgjysmuar. Krahas rrezikimit të vazhdueshëm të shtetit shqiptar, Beogradi, bëri çmos, që me anën e dhunës shtetërore dhe programeve të vazhdueshme (kolonizimit, shpërnguljeve dhe terrorit policor-ushtarak), ta rrënojë qenien etnike dhe atë fizike të shqiptarëve në Kosovë dhe në Maqedoni. Roli i Kishës Ortodokse Serbe në këtë strategji ishte përherë i madh: frymëzues në planin shpirtëror, dhe mobilizues në planin ushtarak. Në luftërat pushtuese (ato të vitit 1878, 1912, 1919 dhe 1999), të përcjella me gjenocide, klerikët ortodoksë jo vetëm që i bekuan armët dhe njësitë paramilitare, por njëherësh, shumë nga objektet e kultit i kthyen në depo armësh si dhe qendra logjistike të armatës serbe. Gjatë shpërthimit të luftës pushtuese serbe në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë në vitet 1991-1999, shërbimet informative perëndimore siguruan shumë dëshmi për këto veprime. Çështje e diskutueshme mbetet pse në Gjykatën e Hagës, krahas Millosheviçit dhe shpurës së tij politike-ushtarake, nuk u gjendën edhe klerikët ortodoksë serbë që frymëzuan dhe ndihmuan drejtpërdrejtë gjenocidet serbe në hapësirat e ish Jugosllavisë. Natyrisht, po të ishte përfshirë në Gjykatën e Hagës edhe ky aspekt, me siguri se nuk do ta kishim Pakon e Ahtisarit në formën që u aprovua me ç’rast Kishës Ortodokse Serbe iu njoh e drejta e trashëgimisë së krishterimit ortodoks në Kosovë bashkë me objektet e kultit (manastiri i Graçanicës, i Deçanit, Pejës, Deviqit, Prizrenit dhe të tjera), trashëgimi kjo që ia pranon “tapitë shpirtërore” Serbisë në Kosovë, të cilat shtetin e Kosovës e zhveshin nga trashëgimia shpirtërore dhe historike. Ndërsa, siç u pa edhe në rastin e Banjës, atë e kthejnë në një qendër të logjistikës terroriste.

2. Aspekti diplomatik

Edhe nga aspekti diplomatik, nuk ka kurrfarë “konflikti të ngrirë” midis shqiptarëve dhe serbëve, pos një luftë të përhershme të diplomacisë serbe, të përkrahur nga ajo ruse po edhe nga diplomacia e disa vendeve evropiane (pa përfshirë edhe atë austro-hungareze e fokusuar të interesat e saj që sllavët e Jugut të ruanin përkatësinë perëndimore), që të ashtuqajturës “e drejtë historike”, të falsifikuar shumanshëm gjoja me shtetin mesjetar serb, që nuk ka ekzistuar kurrë, t’i krijohet “alibia” diplomatike si mjet për realizimin e këtyre qëllimeve. Kjo është parë qysh nga Kriza Lindore e vitit 1867, kur Rusia cariste Paqes së Parisit të vitit 1856, fitoi të drejtën për mbikëqyrje ndaj ortodoksëve të Ballkanit, vuri në lëvizje diplomacinë e saj në shërbim të këtyre qëllimeve. Të tilla ishin nismat për dërgimin e konsujve rusë në viset shqiptare (Shkodër, Prizren, Shkup, Prishtinë, Janinë, Manastir dhe gjetiu),

MASHTRIMI I “KONFLIKTIT TË NGRIRË” ME SERBINË DHE MODELI I DONBASIT DHE CIRKU YNË I MADH



të cilët, krahas veprimtarisë subversive kundër shqiptarëve, do të fillojnë edhe ato të “misionarizmit” kulturor (hapjen e shkollave në gjuhën serbe) si dhe rindërtimin e kishave “ortodokse serbe” nga trashëgimia e përbashkët e krishterimit të zyrtarizuar në Dardani në shekullin IV nga perandori dardan Kostandini i Madh. Krahas këtyre punëve, konsujt rusë organizojnë edhe lëvizjet politike nacionaliste në përputhje me interesat hegjemoniste sllave, ku infiltruashin edhe grupe të armatosura (komitë) nga Serbia, Greqia dhe Bullgaria për arritjen e qëllimeve politike, siç ishin ato që nxorën në pah krizën e Maqedonisë (1889-1903) dhe të tjera me të cilat u krijua platforma diplomatike luftërave pushtuese ballkanike (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë), që shpërthyer në vjeshtën e vitit 1912 kundër Perandorisë Osmane dhe për pasojë patën pushtimin e trojeve shqiptare me pasojë tragjike.

Platforma diplomatike rusomadhe mbrojti interesat e vendeve sllavo-ortodokse në Ballkan në dëm të trojeve shqiptare në Kongresin e Berlinit, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1912 dhe kudo që u dha rasti. Nën petkun e këtij hegjemonizmi, interesimi i Moskës për Serbinë vazhdoi edhe gjatë kohës së komunizmit. Tragjedia shqiptare e viteve 1994/45 si dhe kalvari i vuajtjeve shqiptare vazhdoi edhe në rrethanat e “bashkim-vëllazërimit”, nga që aleanca ideologjike Tiranë-Beograd u ndërta mbi tragjedinë e Kosovës dhe luftën e vazhdueshme për bashkim kombëtar qoftë edhe në rrethanat e vetëvendosjes ideologjike, siç u pasqyrua në Konferencën e Bujanit. Kjo politikë vazhdoi edhe pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe deri në ditët e sotme, me ç’rast Rusia shfrytëzon edhe KS të OKB-së për këto qëllime.

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë si dhe realitetet e reja që u krijuan në hapësirat e saj, me ç’rast, me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990, Kuvendin e Kaçanikut të 7 shtatorit të vitit 1990, Referendumin për Pavarësi të 26 shtatorit 1991 si dhe zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, u krijua legjitimiteti demokratik procesit shtetëformues, i cili u përmbyllur më 17 shkurt 2008, nuk do t’ia ndalë turrin diplomacisë së Beogradit kundër shtetit të Kosovës. Por, këtë herë, për ndryshim, nga destruksioni që ia bëri dialogut politik nga viti 2013-2018 edhe në sajë të strategjisë së gabuar të politikës së Kosovës ndaj kësaj qasjeje, kur aspektet teknike të integritetit të komunitetit serb në Kosovë u zëvendësuan me implikimin e politikës së Beogradit në Kosovë, u pa se me veprimet e fundit në Veri, për ta luftuar shtetin e Kosovës, diplomacia serbe, iu kthye modelit të Donbasit, pra të përdorimit të agresionit shtetëror për qëllime politike.

3. Aspekti politik

Meqë nga aspekti historik dhe diplomatik nuk ka kurrfarë “konflikti të ngrirë” midis shqiptarëve dhe serbëve, pos hegjemonizëm në vazhdimësi të shtetit serb ndaj shqiptarëve, shfaqja e sulmit terrorist këto ditë në

Veri, pretendon, që shteti i Kosovës, i shpallur më 17 shkurt 2008 dhe i justifikuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës në vitin 2010, të rrezikohet me anën e modelit të Donbasit.

Ky skenar serb, vjen pas dështimit të përpjekjeve të dy-tre viteve të fundit që Kosova të hajë karremin e “pajtitit historik” me Serbinë me anën e shkëmbimit të territoreve në Veri, me çka shteti i Kosovës do të futej në pazare të paparashikueshme politike me Serbinë, që për epilog do të kishin shpërbërjen e tij.

Kjo pra tregon, se Serbia, tashmë është në rrugë e sipër që luftën e deritanishme politike kundër shtetit të Kosovës ta kthejë në politikë lufte.

Ky kurs, gjithsesi kërkon që politika e Kosovës të mbështetet te aleatët (SHBA dhe vendet perëndimore), që i kanë ndihmuar të çlirohet nga pushtimi serb. Kjo nënkupton edhe përmbushjen e detyrimeve kushtetuese për integrimin e plotë të pakicave në jetën institucionale, ekonomike dhe kulturore të vendit, ku formimi i asociacionit të komunave në Veri, pa kompetenca ekzekutive, duhet të përmbushet sa më parë.

Tek e fundit, kjo është kërkesë e vazhdueshme edhe e ndërkombëtarëve, të cilët mund të jenë të vetmit garantë të parandalimit të modelit të Donbasit, që siç u pa këto ditë, politika e Beogradit tashmë e ka futur në lojë...

Do të jetë mashtrim i madh, nëse mendohet se atmosfera e “triumfalizmit” të shfaqur këto ditë te ne, mund ta parandalojë këtë skenar.



WE'RE HIRING HEAD CHEF

We are hiring a skilled and passionate cake chef to join our team.
If you have experience in creating cakes and want to be part of a dynamic and creative environment, this opportunity is for you!

Requirements:

- Proven experience as a cake chef, with expertise in baking and decorating cakes of various types and styles
- Strong knowledge of ingredients and techniques to create visually appealing and delicious cakes.

Responsibilities:

- Assist in the production of handmade and hand-decorated sponge cakes
- Passion to design and create
- Attention to detail.
- Decorating customer orders
- Expert at hand piping messages in buttercream and chocolate
- Must have the right to live and work in the UK

What we offer:

- Excellent hourly rates
- Full-Time work
- Monday to Friday
- Weekend availability
- Staff uniform
- Free meals provided every shift and 30% staff discount.
- Christmas and Easter bonuses



FOR MORE INFORMATION CONTACT US:
PHONE: +44 20 8245 8021
email:borneocafebakery@outlook.com

VETON SURROI

Nëse të katër liritë evropiane janë liria e qarkullimit të papenguar të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, në Banjškë u shndërruan në lirinë e lëvizjes së grupit paramilitar, të mallrave si granatahedhësi M93 (me kapacitet prej 40- 500 granata në minutë), të shërbimeve për destabilizimin e Kosovës (dhe pranisë së NATO-s në të). Në këto kushte garantohet lëvizja e lirë edhe e kapitalit, me thasë parash të gatshme nga çdo kontrabandë dhe korrupsion i mundshëm. Procesi i Berlinit mund të vazhdojë kështu apo të kërkojë lirinë e pestë, lirinë nga frika.

1.

Ka disa vjet, qoftë nëpërmjet Procesit të Berlinit, qoftë pastaj me iniciativën jo jetëgjatë të quajtur "Open Balkan" (më herët Mini-Shengen), që proklamohet se zgjidhja për problemet e Ballkanit Perëndimor është vendosja e katër lirive evropiane. Konferencë pas konference, samit pas samiti dhe do të përsëritet nga shumë liderë të vendeve të Ballkanit Perëndimor se kjo hapësirë duhet të ketë lirinë e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Pra, që kufijtë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor të jenë të njëjtë sikur ata mes shteteve të BE-së. Dhe, atëbotë ky regjion do të jetë i gatshëm për integrim në BE.

Samiti i parë në Berlin më 2014 inicioi ligjërimin se katër liritë do të bëjnë zgjidhjen e problemeve. Samiti i ardhshëm do të mbahet në Tiranë gjatë këtij muaji dhe nëntë vjet më pas vëmendja e liderëve do të duhej të shtronte një pyetje themelore: si u bë që pas gjithë këtyre vite ligjërimi për katër liritë evropiane (madje stereo, në Proces të Berlinit e Open Balkan) një grup paraushtarak i trajnuar dhe i armatosur në Serbi sulmoi Kosovën?

Apo, mbase, liderët do të preferonin t'i qëndronin besnikë agjendës, dhe të bisedojnë për marrëveshje mobiliteti, të nënshkruara vitin e kaluar në Berlin? Edhe po të preferonin këtë, nuk është se kanë me çka të mburren. Në nëntor të vitit 2022, kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan tri marrëveshje të quajtura të lëvizshmërisë; më e dukshme nga të cilat ishte lëvizja e qytetarëve me letërnjoftimet e vendeve të tyre.

Këto marrëveshje nuk arritën të ratifikohen në të gjashtë vendet, me BH-në të bllokuar nga Dodiku. Serbia, ndonëse ratifikoi, po ashtu bëri një fizkulturë legediplomatike duke e njohur Maqedoninë e Veriut si depozitare të marrëveshjeve (por jo edhe shtetet e tjera pjesëmarrëse) se nënshkrimi i Serbisë nuk nënkupton njohjen e Kosovës si të barabartë në aftësinë e saj ligjore.



2.

Nëse i qëndrojnë agjendës, atëherë mund të vazhdojnë ligjërimin, vetëlavdërimin dhe inicimin e marrëveshjes së ardhshme, atë për njohjen e të drejtës së infermiereve për të punuar në të gjashtë shtetet (që nuk quhen zyrtarisht shtete). Në samitin e ardhshëm mbase do të iniciojnë marrëveshjen për mobilitetin e shoferëve të kamionëve e autobusëve, e kështu me radhë.

Ose, mund të bëjnë një pyetje të thjeshtë: pse nuk po mund të vendosen katër liritë evropiane në këtë pjesë të Evropës, edhe pse kori i atyre që këndojnë këtë këngë në mesin e politikanëve nuk ka qenë ndonjëherë më i madh?

Ndoshta, sepse përgjigjja mund të dalë se ekziston në këtë hapësirë liria e pestë, ajo që u ilustrua në Banjškë më 24 shtator të këtij viti. Nëse të katër liritë evropiane janë: liria e qarkullimit të papenguar të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, atëbotë me lirinë e pestë këto shndërrohen në lirinë e lëvizjes së grupit

paramilitar, të mallrave sgranatahedhësi M93 (me kapacitet prej 40- 500 granata në minutë), të shërbimeve për destabilizimin e Kosovës (dhe pranisë së NATO-s në të). Në këto kushte garantohet lëvizja e lirë dhe e kapitalit, me thasë parash të gatshme nga çdo kontrabandë dhe korrupsion i mundshëm.

Liria e pestë është liria e arbitraritetit, e shpërfilljes së një rendi evropian të vendosur mbi rregullat. Siç u pa në Banjškë, katër liritë evropiane marrin formë krejtësisht tjetër prej atyre të vendeve të BE-së kur të aplikohet liria e pestë.

3.

Mund të thuhet se shpikësi i lirisë së pestë është Serbia. Kur Kosova shpalli pavarësinë më 2008, Serbia tha se ky akt ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe kërkoi që këtë interpretim të saj ta konfirmojë trupi më i lartë i ndarjes së drejtësisë ndërkombëtare, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Ajo më 2010 dha mendimin e vet mospajtes me mendimin e Serbisë. Serbia vendosi

të mos pajtohet me realitetin e edhe me Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe 13 vjet më pas deklaroi se është duke kërkuar drejtësi.

Prej atëherë deri më sot, Serbia ka zbatuar me sukses lirinë e pestë, përfshirë edhe në përshkallëzimin më të ri, të futjes së njësitit paraushtarak në Banjškë. Kur u thuhet se kjo është kundër ligjit, përgjigjja nga autoritetet e Serbisë është se ky akt është veprim legjitim kundër "terrorit të Kurtit". Por, do të ishte e padrejtë që për lirinë e pestë të ngarkohej vetëm Serbia. Presidenti Vuçiq ka testuar suksesshëm vendosmërinë e një Evrope të rendit e të rregullave dhe ka parë se një e tillë mund të ekzistojë në relacionin mes Gjermanisë e Francës, por jo domosdoshmërisht mes këtyre dhe Ballkanit Perëndimor.

Diplomat pas diplomati francez e gjerman kanë shkuar në Beograd dhe kanë ardhur në Prishtinë për të rrëfyer se si nëse Gjermania dhe Franca janë pajtuar pas aq shumë shekujsh lufte, është gjithsesi shumë më lehtë që këtë ta bëjnë Kosova dhe Serbia. Vetëm se këta nuk kanë kuptuar ndonjëherë se

pajtimi gjermano-francez erdhi pasi që përfunduan luftërat. Kosova dhe Serbia nuk e kanë përfunduar konfliktin, e kanë vazhduar me mjete të tjera dhe ky konflikt ka arritur të kthehet tek shembujt e viteve '90 të shekullit të kaluar, kur njësitet paraushtarake serbe niseshin kundër Kroacisë e BH-së për të "mbrojtur popullin prej terrorit kroat", "prej terrorit ustash", "prej terrorit muxhahedin" e të ngjashme.

Serbia mund të flasë për tregti, bashkëpunim ekonomik, katër liri dhe njëkohësisht të shpallë se veriu i Kosovës është i okupuar, duke legjitimuar çdo përdorim force për të "çliruar" veriun nga okupatori. Ajo mund të përdorë njëkohësisht gjuhë të ndritur të Procesit të Berlinit dhe gjuhë toksike të procesit të zhbërjes së Jugosllavisë, dhe këtë do ta bëjë derisa kështu të jetë e pranueshme për BE-në dhe SHBA-në.

4.

Katër lirive evropiane u nevojitet një tjetër liri e pestë. Qytetarët e shteteve të BE-së e marrin si të mirëqenë paqen, por ajo nuk u erdhi e paketuar, u ndërta vit pas viti, me bashkëpunim e me institucione, me negociata e kompromise, madje me arritje konsensusi. Por, para se i tërë ky zhvillim të ishte i mundshëm, shtetet e atëherëshme që inicioan BE-në si projektin më të madh të paqes ndonjëherë arritën lirinë e pestë, lirinë e frikës nga shteti fqinj, lirinë se ky fqinj do ta vazhdojë luftën me mjete të tjera, duke mos e përjashtuar edhe atë të armatosur. Projekti i BE-së do të ishte i pamundur pa besimin e ndërsjellë në siguri, të ofruar nga NATO-ja.

Këtë liri nuk e kanë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë hapësirë shtetesh e luftërash të papërfunduara, liria e pestë mbetet ajo e arbitraritetit.

Banjška mund të jetë një përkujtim i esllt se duhet arritur lirinë fillestare evropiane, të lirisë nga frika prej fqinjit, lirinë për të ndier siguri. Dhe se pa lirim nga kjo frikë, të ndërtaur me arkitekturë të përbashkët sigurie, katër liritë evropiane nuk mund të krijohen në këtë hapësirë. marrë nga Koha Ditore

IL POPOLO ROMANO 1919 / ÇËSHTJA E SHQIPËRISË NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS

“Il Popolo Romano” ka botuar, të hënën e 10 marsit 1919, në ballinë, intervistën ekskluzive të Hasan Bej Prishtinës në Romë në lidhje me të ardhmen e kombit shqiptar si dhe opinionin e tij mbi serbët dhe grekët, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet blogut të tij “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :


Çështja e Shqipërisë

Shqiptarët i presin me ankth të shpjegueshëm vendimet e Konferencës së Parisit.

Në fakt, ata aspirojnë jo vetëm njohjen e pavarësisë së tyre shtetërore, por edhe rikthimin e territoreve të tyre kombëtare të pushtuara nga grekët dhe serbët.

Një figurë e shquar shqiptare, Hasan bej Prishtina, ndodhet në Romë dhe, kur u pyet për pretendimet jugosllave për Shkodrën dhe brigjet e Drinit, deklaroi:

Kërkesat e serbëve, psikologjinë e të cilëve e njoh, nuk më befasojnë dhe as nuk i trembin të tjerët që dinë diçka për ta. Nëse rastësisht takoni një serb të Aleksandrit të Madh, ai do t’ju thotë se Shkodra ose Drini ishte serb. A e kapni thelbin? Ai do të përgjigjet se serbët në këtë drejtim kanë prioritet ndaj kombeve të tjera. Për sa i përket ambicieve të tyre territoriale, këto shtrihen nga Adriatiku në Mesdhe, deri në Detin e Zi. Deliri i madhështisë së serbëve rrjedh pjesërisht nga megalomania që i atribuohet përgjithësisht persëve dhe grekëve; dhe është mjaft e çuditshme që Antanta, e cila është përgjegjëse për rigjenerimin e fatit të botës, nuk ka



depërtuar ende në mentalitetin serb.

Nuk u çudita aspak kur ata kërkuar Triesten, Fiumen dhe pretenduan gjithashtu zonën e Piave-s.

Prandaj serbët duan territorin e Drinit, i njohur si pjesë e Shqipërisë në Konferencën e Londrës, në të cilin nuk ka asnjë element tjetër sllav, përveç rreth pesëdhjetë malazezëve të përkushtuar ndaj tregtisë. Edhe këta malazez njohin vetëm Shqipërinë.

Sa për Prizrenin, Gjakovë, Pejën, Pr-

ishtinën, Dibrën, Mitrovicën, Vushtrinë, Ferizajn, Gjilanin, Kaçanikun, Tetovën, Shkupin, Gostivarin, nga një numër i përafërt prej shtatëqind mijë banorësh ka vetëm 60 apo 70 mijë serbë, ndërsa pjesa tjetër është element shqiptar. Ky minoritet serb përbëhet për më tepër nga bullgarë të cilët kryesisht janë shkombëtarizuar nga ndikimi i parave.

Kjo që po them nuk është një deklaratë e paqartë e ngjashme me argumentet me të cilat serbët i mbështesin pretendimet e tyre.

Mbi të gjitha, më dhemb fakti që një pjesë e shtypit francez, pa parë nga e ardhmja, është e prirur të mbështesë aspiratat e serbëve.

Kush mund të garantojë pamundësinë e një bashkimi ndërmjet serbëve dhe armiqve të tyre të lashtë?

— Çfarë mendoni për pretendimet greke për Epirin?

— Grekët duhet të bindin veten se ekzistenca e një Shqipërie të respektuar në Ballkan do të sjellë përfitime

të mëdha për ta.

Sepse grekët herët a vonë do të ekspozohen ndaj rrezikut të agresionit sllav. Pavarësisht nga një pakicë greke në ndikimin e shkollave greke, shumica në këtë pjesë të Shqipërisë i përket popullsisë së krishterë dhe myslimane shqiptare.

Janë mbi 40 mijë të krishterë shqiptarë nga Epiri në Amerikë, të cilët e dëshmojnë lidhjen e tyre të padashmë me atdheun e tyre përmes propagandës së tyre patriotike dhe botimeve të shumta në gjuhën kombëtare.

Prandaj është në interesin e vetë grekëve që të mos këmbëngulin në këtë çështje që do të ngjallte pakënaqësi të përgjeshme te shqiptarët. Grekët do të gjejnë në Ballkan një miqësi të sinqertë me shqiptarët ditën që do të heqin dorë nga pretendimet e tyre ndaj Shqipërisë, sepse të dy kombet kanë të njëjtë armiq të ardhshëm.

Italia ka një interes jetik që Shqipërisë t’i kthehet integriteti territorial, ndërsa nga Vlora do ta monitorojë me dashuri këtë integritet.

Opinionimi publik italian po ndjek me vëmendje të veçantë fazat e çështjes shqiptare dhe synon ta bëjë çështjen e tij. Nëse në konferencë do të vendoset drejtësia, shqiptarët e presin!

PROTOKOLLI DIPLOMATIK I NJË BANDUSTANI

SHABAN MURATI

Nëse doni të kuptoni degradimin e dinjitetit shtetëror mjafton të shikoni foton e publikuar nga ATSH për bisedimet e zhvilluara në 6 tetor në kryeministri midis ministrit të jashtëm të Greqisë G.Gerapetritis dhe kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, i shoqëruar nga ministri i jashtëm i Shqipërisë.

Në tavolinën e bisedimeve janë ulur përballë njeri-tjetrit dy delegacionet e dy qeverive, siç zhvillohen bisedimet e niveleve të njehta në protokollin diplomatik ndërkombëtar.

Cila perëndi greke e Olimpët zbriti në kryeministri, që duhej nderuar përtej prokollit sa të uleshin me përunjësi përballë saj dyshja më e lartë qeveritare e Shqipërisë, kryeministri dhe

ministri i jashtëm?

Si mundet kryeministri i Shqipërisë të zhvillojë bisedime zyrtare delegacionesh me një rang më të ulët se posti i tij, në një kohë kur sipas protokollit shtetëror diplomatik ai mund ta takonte ministrin e jashtëm grek duke qendruar në dy kolltukë apo karrike të ndara anash njeri-tjetrit, por kurrsesi të zhvillonte bisedime zyrtare delegacionesh dypalëshe me të.

Nuk po bëjmë pyetjen tjetër se përse kryeministri i Shqipërisë zhvilloi bisedime dhe priti në zyrën e tij vetëm ministrin e jashtëm grek dhe nuk priti as ministrin e jashtëm të Gjermanisë dhe asnjë nga 24 ministrat e jashtëm, që ndodheshin në Tiranë në 6 tetor për mbledhjen e ministrave të jashtëm të Ballkanit Perëndimor në kuadrin e



“Procesit të Berlinit” të drejtuar nga Gjermania. Nuk po bëjmë as pyetjen tjetër se çfarë do të bëjë më tepër protokollit i fandaksur kryeministrit kur të vijë në Tiranë kryeministri grek. Ministri i jashtëm i Greqisë ka për ho-

në 8 janar 2021 kur në mënyrën më antidiplomatike shkon në selinë e ministrisë së jashtëme greke në Athinë dhe zhvillon atje bisedime dypalëshe me ministrin e jashtëm grek Dendias.

molog ministrin e jashtëm të Shqipërisë dhe me atë ka tagrin që të zhvillojë bisedime dypalëshe. Ndoshta Shqipëria, që ende nuk ka kuptuar se ç’është dinjiteti i shtetit, ndjek manualin diplomatik të bandustanit, kur i pari i fisit ka monopolizuar gjithçka, dhe është bërë si xholi që hyn kudo vend e pa vend.

Kryeministri i Shqipërisë e ka bërë praktikë këtë shkelje protokollare diplomatike, sepse një skandal të tillë e ka bërë

Në librin tim “Deti midis Shqipërisë dhe Greqisë” kam shkruar lidhur me këtë: “Asimetria e nivelit të bisedimeve tregon se si do t’i nënvlehtësojë Greqia çështjet e hapura me Shqipërinë”. Në një situatë të tillë shtrohet çështja nëse është Shqipëria, që i nështrohet si shtet raja protokollit fyes grek, apo është profanizmi diplomatik i kryeministrit të saj.

Mirë e bënë turpin diplomatik dhe personal, duke zhvilluar bisedime në ministër grek me dyshen qeveritare kryeministër dhe një ministër shqiptar, por si kanë faqe dhe ia bëjnë të njohur publikut këtë dëshmi të re të uljes së dinjitetit të Shqipërisë.

Dhe kur sheh se si shtiret bandustani si shtet, kupton pse “bota qesh, dhe bota tallet” me ne.

Akoma nuk keni një website?



**Akoma nuk jeni
regjistruar në
Google?**

*Porosit
websitin tend*

Për çdo konsultim mund të vini tek zyrat tona

**Adresa e zyrave: 30 Avenons Road
London E13 8HT**

NA KONTAKTONI:

TEL: 020 7018 7929


MOB: 073 4066 5946

MOB: 078 5997 7545



NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen-: 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose

Dëshironi një **Banner** për biznesin tuaj?



- **Business Cards**
- **-Logos**
- **-Invoices**
- **-Posters**
- **-Banners**
- **-Video Marketing**
- **-Online Marketing**

 **Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT**

 **Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946**
Mob: 078 5997 7545